



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 145

Tiranë – E martë, 29 tetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 16.10.2019	Për një shtesë fondesh, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, për financimin e aktiviteteve që do të organizohen me rastin e 75-vjetorit të Çlirimit të vendit..... 12019
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 681, datë 23.10.2019	Për largimin nga detyra të një anëtari të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura..... 12020
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 682, datë 23.10.2019	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pasurisë nr. 3/200, zona kadastrale 8561, me emërtimin ish-Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë, Njësia Administrative Korçë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar..... 12020
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 684, datë 23.10.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i nënstacionit 400 kV Fier”..... 12022
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 23.10.2019	Për kryerjen e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit..... 12024
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 23.10.2019	Për miratimin e zonës arkeologjike “A” të qytetit të Elbasanit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj..... 12024
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 688, datë 23.10.2019	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Rezar Veseli..... 12028
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 689, datë 23.10.2019	Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave të shpalljes së kurorës së gjelbër dhe përcaktimin e rregullave e të përgjegjësisë në lidhje me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e saj..... 12028

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 690, datë 23.10.2019	Për dhënien me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës B, kati 0 (<i>underground</i>) në ambientet e Pallatit të Kongreseve, Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.....	12031
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 691, datë 23.10.2019	Për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.....	12031
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 2.10.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.....	12031
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 694, datë 2.10.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, të ndryshuar.....	12034
Udhëzim i ministrit të Mbrojtjes nr. 6, datë 17.5.2019	Për procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit, si pasojë e konfiskimit.....	12035
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 24, datë 21.10.2019	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 5, datë 19.2.2018, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”.....	12037
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Brendshëm nr. 651, datë 13.9.2019	Për procedurat e raportimit, të rasteve të fëmijëve në nevojë, për mbrojtje.....	12037
Rregullore e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2, datë 24.10.2019	Për organizimin e tregjeve të produkteve të peshkimit.....	12039
Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut , nr. 29309/16, datë 11.6.2019	Çështja Prizreni kundër Shqipërisë.....	12042
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 146, datë 4.10.2019	Mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e periudhës tranzitore të vendosur me pikën 2, të vendimit nr. 46, datë 19.3.2019, të bordit të ERE-s, deri në fund të vitit 2019.....	12051
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 147, datë 4.10.2019	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	12054
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 148, datë 4.10.2019	Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., për miratimin e disa shtesave në “Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017.....	12055
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Emorela Dema.....	12057
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Mariglen Trajani.....	12058

Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të vdekur të shtetases Rabije Azizi.....	12058
Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Adriano (Fatosh) Jaho (Jaha).....	12058



VENDIM

Nr. 678, datë 16.10.2019

**PËR NJË SHITESË FONDESH, NË
BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN
2019, PËR FINANCIMIN E
AKTIVITETEVE QË DO TË
ORGANIZOHEN ME RASTIN E 75-
VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetet e institucioneve, për financimin e aktiviteteve që do të organizohen me rastin e 75-vjetorit të çlirimit të vendit, bëhen shtesat, si më poshtë vijojnë:

a) Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e vitit 2019, i shtohen:

i. 15 120 000 (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet mijë) lekë në programin “Trashëgimia kulturore dhe muzetë”, në artikullin 604, për mbulimin e shpenzimeve për aktivitetet e organizuara nga Ministria e Kulturës dhe Bashkia Tiranë.

ii. 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë në programin “Arti dhe kultura”, në artikullin 604, për mbulimin e shpenzimeve për aktivitetet e organizuara nga Ministria e Kulturës;

b) Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e vitit 2019, në programin “Planifikim menaxhimi administrimi”, në artikullin 604, i shtohet fondi 3 000 000 (tre milionë) lekë për mbulimin e shpenzimeve të kryera nga Organizata e Veteranëve të LANÇ-it;

c) Radiotelevizionit Shqiptar, në programin “Prodhome filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare”, në artikullin 604, i shtohet fondi 2 000 000 (dy milionë) lekë për mbulimin e shpenzimeve për aktivitetet e organizuara në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.

2. Fondet, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, në shumën e përgjithshme 30 120 000 (tridhjetë milionë e njëqind e njëzet mijë) lekë, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Radiotelevizioni Shqiptar, Bashkia Tiranë dhe Organizata e Veteranëve të LANÇ-it për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

SHTOJCA NR. 1

Institucioni ku janë alokuar fondet	Shuma e akorduar në lekë	Institucioni përgjegjës për organizimin e aktiviteteve
Ministria e Kulturës	25 120 000	Ministria e Kulturës: shuma 15 620 000 lekë - Ekspozita “Shqipëria 75 vjet imazhe, 1944–2019” - Ekspozitë e hapur me fotografi të përmasave të mëdha në Tiranë - Ekspozitë “Rezistenca shqiptare gjatë Luftës II Botërore”, në hollin e MHK-së - Përkthim dhe botim i librit të Sir Anthony Quayle “Egjit hours from England”. Bashkia Tiranë: shuma 9 500 000 lekë - Riparimi i varreve në Varrezat e Dëshmorëve - Banderolat me portretet e dëshmorëve të LANÇ-it
Ministria e Mbrojtjes	3 000 000	Organizata e Veteranëve të LANÇ-it: 3 000 000 lekë - Zhvillimi i konferencës shkencore kombëtare/ ndërkombëtare, me rastin e 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, sipas zërave: - shpenzime për të ftuarit (udhëtim, hotel, ushqim) - libri me kumtesat - honorare për kumtuesit - koktejl, darka - baneri, taksì, publicitet - kancelari për eventin
Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH)	2 000 000	Radiotelevizioni Shqiptar: 2 000 000 lekë - Për organizimin e koncertit “Tinguj lufte” në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë



VENDIM

Nr. 681, datë 23.10.2019

**PËR LARGIMIN NGA DETYRA TË NJË
ANËTARI TË KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE
TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Eltar Deda, anëtar i Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, largohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 682, datë 23.10.2019

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË
ADMINISTRIMIT, NGA DREJTORIA E
PËRGJITHSHME E ARKIVAVE TEK
AGJENCIA SHETËTËRORE E
KADASTRËS, TË PASURISË NR. 3/200,
ZONA KADASTRALE 8561, ME
EMËRTIMIN ISH-DREJTORIA
RAJONALE E SHËRBIMIT KOMBËTAR
TË PUNËSIMIT, KORÇË, NJËSIA
ADMINISTRATIVE KORÇË DHE PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 660,
DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pasurisë nr. 3/200, zona kadastrale 8561, me emërtimin ish-Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë, Njësia Administrative Korçë, sipas hartës kadastrale, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me qëllim ushtrimin e funksioneve administrative të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Korçë.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar.



3. Agjencisë Shtetërore të Kadastrës i ndalohej të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



**VENDIM****Nr. 684, datë 23.10.2019**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I
NËNSTACIONIT 400 kV FIER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i nënstacionit 400 kV Fier”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme 12 850 972 (dymbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 12 850 972 (dymbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh, do të përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., si subjekti kërkuar i këtij shpronësimi.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim në zyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST), sh.a., të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të OST sh.a.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Fier të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË PROJEKTIT “NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400 kV FIER”

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: “Tokë arë”

Nr.	Të dhëna për pronësinë							Sip. e shpronësuar m²	Çmimi lekë/m²	Vlera e shpronësimit në lekë	Vlera kulturave bujqësore	Vlera totale e shpronësimit në lekë	Shënime.
	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sip. totale e pronës m²						
Bashkia Fier													
Drizë		Zona kadastrale nr. 1557											
1	Shaban	Sihat	Gjeli	arë	1557	190/1	2,218	2,218	269	596,642	30,800	627,442	Konfirmuar nga ZVRPP Fier, Kufizim pronësie
2	Iljaz	Nurce	Shateri	arë	1557	192/1	878	878	269	236,182	12,250	248,432	Pa certifikatë pronësie
3	Nuredin	Iljaz	Shateri	arë	1557	192/2	437	437	269	117,553	6,300	123,853	Pa certifikatë pronësie
4	Fatmir	Xhemil	Brakaj	arë	1557	250/7	4,557	4,557	269	1,225,833	63,700	1,289,533	Me certifikatë pronësie
5	Ymer	Dine	Muhameti	arë	1557	250/8	4,187	4,187	269	1,126,303	230,050	1,356,353	Pa certifikatë pronësie
6	Ismail	Muhamet	Muhameti	arë	1557	250/9	4,125	4,125	269	1,109,625	57,750	1,167,375	Pa certifikatë pronësie
7	Fetah	Rrapush	Hoxha	arë	1557	250/10	2,312	2,312	269	621,928	401,100	1,023,028	Pa certifikatë pronësie
8	Ali	Kodhel	Myrto	arë	1557	250/12	406	406	269	109,214	5,600	114,814	Pa certifikatë pronësie
9	Zyni	Ali	Myrto	arë	1557	250/13	2,093	2,093	269	563,017	754,450	1,317,467	Pa certifikatë pronësie
10	Shpresa	Rrapo	Myrto	arë	1557	250/14	1,937	1,937	269	521,053	633,750	1,154,803	Pa certifikatë pronësie
11	Xhevair	Ali	Myrtaj	arë	1557	250/15	1,625	1,625	269	437,125	285,200	722,325	Me certifikatë pronësie
12	Luan	Idai	Gjata	arë	1557	250/16	562	562	269	151,178	5,950	157,128	Pa certifikatë pronësie
13	Agron	Idai	Gjata	arë	1557	250/17	875	875	269	235,375	9,100	244,475	Pa certifikatë pronësie
14	Kostandin	Vangjel	Saramanda	arë	1557	250/18	1,078	1,078	269	289,982	15,400	305,382	Me certifikatë pronësie
15	Zoi	Vangjel	Saramanda	arë	1557	250/19	1,078	1,078	269	289,982	15,400	305,382	Me certifikatë pronësie
16	Bani	Llazi	Bare	arë	1557	250/20	1,000	1,000	269	269,000	14,000	283,000	Me certifikatë pronësie
17	Filip	Tezho	Bare	arë	1557	250/22	1,000	1,000	269	269,000	14,000	283,000	Pa certifikatë pronësie
18	Mihal	Tezho	Bare	arë	1557	250/23	1,000	1,000	269	269,000	14,000	283,000	Pa certifikatë pronësie
19	Nikollaq	Todi	Bare	arë	1557	250/25	1,776	1,776	269	477,744	23,800	501,544	Me certifikatë pronësie
20	Feti	Meto	Gjata	arë	1557	250/26	974	974	269	262,006	13,650	275,656	Pa certifikatë pronësie
21	Flutura	Feti	Gjata	arë	1557	250/27	187	187	269	50,303	2,800	53,103	Pa certifikatë pronësie
22	Ismet	Feti	Gjata	arë	1557	250/28	1,278	1,278	269	343,782	17,850	361,632	Me certifikatë pronësie
23	Mihal	Taqi	Bare	arë	1557	250/29	1,407	1,407	269	378,483	19,600	398,083	Pa certifikatë pronësie
24	Dhoksi	Llazi	Bare	arë	1557	250/30	898	898	269	241,562	12,600	254,162	Me certifikatë pronësie
Sipërfaqe totale shpronësimi m²								37,888					
Vlera totale e shpronësimit në lekë për sipërfaqet e pronësisë										10,191,872			
Vlera e shpronësimit në lekë për kulturat bujqësore											2,659,100		
Vlera totale e shpronësimit në lekë												12,850,972	

**VENDIM****Nr. 686, datë 23.10.2019**

**PËR KRYERJEN E PRAKTIKËS
PROFESIONALE PËR PROFESIONIN E
RREGULLUAR TË MËSUESIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, i cili është 1 500 (një mijë e pesëqind) praktikantë për të gjitha institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, për një vit shkollor.

2. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, i paguan praktikantët, çdo muaj, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

3. Shpërndarja e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për të gjitha institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, për secilin vit shkollor, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, bazuar në kërkesat e institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

4. Efektet financiare për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2019 mbulohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në buxhetin e vitit 2019, sipas numrit të praktikantëve të pranuar nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 687, datë 23.10.2019**

**PËR MIRATIMIN E ZONËS
ARKEOLOGJIKE “A” TË QYTETIT TË
ELBASANIT DHE TË PLANIT PËR
RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 9, dhe të nënndarjes “iv”, të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 53, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e zonës arkeologjike “A” të qytetit të Elbasanit, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonës arkeologjike “A”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 445, datë 9.6.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës arkeologjike “A” të qytetit të Elbasanit dhe miratimin e rregullores së administrimit”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Koordinatat e Zonës Arkeologjike “A”, Elbasan WGS 84		
Nr.	Long.	Lat.
1	20° 4' 47.553" E	41° 6' 43.997" N
2	20° 4' 46.815" E	41° 6' 45.690" N
3	20° 4' 41.262" E	41° 6' 55.826" N
4	20° 4' 53.362" E	41° 6' 59.436" N
5	20° 4' 55.972" E	41° 7' 0.216" N
6	20° 5' 2.180" E	41° 6' 48.245" N
7	20° 4' 55.182" E	41° 6' 46.091" N
8	20° 4' 56.352" E	41° 6' 43.964" N
9	20° 4' 58.359" E	41° 6' 41.586" N
10	20° 4' 54.325" E	41° 6' 40.421" N
11	20° 4' 53.257" E	41° 6' 42.562" N
12	20° 4' 52.828" E	41° 6' 42.803" N
13	20° 4' 51.351" E	41° 6' 45.044" N



Zona Arkeologjike "A" e qytetit të Elbasanit

**MIRATOHET:****KRYEMINISTRI**
Edi RAMA

MINISTRIA E KULTURËS

Ministër
Elva MARGARITI

INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS

Drejtor
Arta DOLLANI

AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

Drejtor
Rudina ZOTO

Legjenda:

Zona arkeologjike "A"

Vendim Nr. ____ Datë ____/____/2019



PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E ZONËS ARKEOLOGJIKE “A” TË QYTETIT TË ELBASANIT

Neni 1 Qëllimi

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse, për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonës arkeologjike “A” të qytetit të Elbasanit, si dhe përcaktimin e kufijve të saj, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

Neni 2 Hapësira urbane arkeologjike në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje me vlera arkeologjike, historike dhe kulturore e qytetit të Elbasanit përbëhet nga zona arkeologjike “A”.

2. Kufijtë e zonës arkeologjike “A” të qytetit të Elbasanit paraqiten në hartën e zonifikimit shoqëruar me koordinatat gjeografike, pjesë përbërëse e këtij plani.

3. Plan i përgjithshëm vendor i Bashkisë së Elbasanit merr parasysh kufijtë e zonifikimit të zonës arkeologjike “A” të qytetit të Elbasanit, si dhe planin për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj.

Neni 3 Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A”

1. Në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Elbasanit lejohet vetëm:

a) mirëmbajtja, restaurimi dhe konservimi i integruar i monumenteve të kulturës dhe strukturave arkeologjike, pas shqyrtimit dhe miratimit të projekteve nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim “KKTKM”);

b) kryerja e formave të testimit, të tilla si: sondazhe që nuk cenojnë shtresat arkeologjike, studime gjeofizike, regjistrim digjital i terrenit, të përcaktuara me vendim të KKTKM-së;

c) zbatimi i projekteve kërkimore shkencore të miratuara nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKTKM-ja;

ç) rikonstruksioni i rrugëve dhe të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja;

d) rikonstruksioni/rindërtimi i godinave ekzistuese pa ndryshim të gjurmës, volumi i përgjithshëm i të cilave nuk cenon pasuritë kulturore të nëntokës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja;

dh) vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 1 kat, në funksion të informimit publik, që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, trashëgiminë kulturore, si dhe nevojave të tjera të rikualifikimit urban të zonës, si më poshtë:

i. konstruksionet duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin;

ii. projekti për vendosjen e konstruksioneve të lehta miratohet nga KKTKM-ja dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen dhe vendndodhjen e strukturës;

iii. vendosja e tyre duhet të bëhet nën mbikëqyrjen e institucioneve shtetërore të specializuara.

2. Projektet lidhur me ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A”, të qytetit të Elbasanit, të parashikuara në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja dhe më pas vijnë në procedurën sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Neni 4 Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A”

1. Për ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Elbasanit, projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 80, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Për çdo rast, KKTKM-ja shqyrton dhe vendos për kryerjen ose jo të formave të testimit. Testimet kryhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe/ose subjekte të licencuara në fushën e arkeologjisë. Shpenzimet për kryerjen e formave të testimit mbulohen nga investitori.

3. Testimet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 3, kryhen sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku në çdo rast njëra nga palët



nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, në vijim “IKTK”.

4. Për ndërhyrjet e parashikuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 3, përpara zbatimit të tyre, me miratim të KKTKM-së, nga subjekte të licencuara ose institucionet e specializuara shtetërore realizohen:

a) format e testimit sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 3, të mbikëqyrura nga institucionet shtetërore të specializuara;

b) monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucione shtetërore të specializuara.

5. Për të gjitha ndërhyrjet në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Elbasanit realizohet monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucione shtetërore të specializuara dhe mbikëqyrje arkeologjike nga institucionet e specializuara shtetërore.

Neni 5

Procedura që ndiqet në rast ndërhyrjesh të paautorizuara në zonën arkeologjike “A”

1. Në rast konstatimi ndërhyrjesh të paautorizuara brenda zonës arkeologjike “A”, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (në vijim “DRTK”) përgjegjëse për qytetin e Elbasanit, ka detyrimin të ndërpresë menjëherë veprimtarinë e subjektit, nëpërmjet aktit të konstatimit.

2. DRTK-ja përgjegjëse për qytetin e Elbasanit njofton menjëherë IKTK-në, institucionin kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionin kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, si dhe strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

3. Në rast se subjekti nuk ndërpret veprimet brenda 24 orëve, DRTK-ja përgjegjëse për qytetin e Elbasanit, i drejtohet menjëherë institucionit kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionit kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, për marrjen e masave përkatëse në zbatim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 6

Gjetjet rastësore arkeologjike

1. Në rast gjetjesh rastësore arkeologjike, gjatë zbatimit të punimeve në zonën arkeologjike “A” të

qytetit të Elbasanit, punimet pezullohen menjëherë, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 145, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Në varësi të vlerave që përmbajnë gjetjet rastësore arkeologjike, KKTKM-ja shprehet për procedurën dhe hulumtimet arkeologjike të nevojshme për ruajtjen e mbrojtjen e tyre.

3. Për çdo rast, veprimtaria arkeologjike realizohet sipas parashikimeve të neneve 139, 145, 146, 147, 260, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 7

Vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese

1. Në zonën arkeologjike “A” lejohe vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, pas shqyrtimit e miratimit nga KKTKM-ja.

2. Në asnjë rast, tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo konkurrojnë monumentet, dëshmitë dhe gjetjet arkeologjike.

3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të mbrojtura rreth tyre, dëshmime dhe gjetjet arkeologjike bëhet nën mbikëqyrjen e DRTK-së përgjegjëse për qytetin e Elbasanit, pas lajmërimit zyrtar nga Bashkia Elbasan.

4. Është e ndaluar vendosja e posterave apo e mjeteve të tjera reklamuese, si dhe dëmtimet e tjera (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme) të monumenteve dhe rrënojave arkeologjike.

Neni 8

Trajtimi i rasteve të paparashikuara

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë plan, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara.

**VENDIM****Nr. 688, datë 23.10.2019****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË Z. REZAR VESELI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Rezar Veseli, në masën 1 000 000 (një milion) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 689, datë 23.10.2019****PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË
PROCEDURAVE TË SHPALLJES SË
KURORËS SË GJELBËR DHE
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE E TË
PËRGJEGJËSIVE NË LIDHJE ME
ADMINISTRIMIN, MBROJTJEN DHE
RUAJTJEN E SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Miratimin e kriterëve dhe të procedurave të shpalljes së kurorës së gjelbër dhe përcaktimin e rregullave e të përgjegjësive në lidhje me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e saj.

Faqe | 12028

2. Kurora e gjelbër përbëhet nga territore ose zona relativisht të vogla në zonat periferike urbane, që përfshijnë pjesë toke, si: sipërfaqe pyjore apo tokë me bimësi pyjore, pemëtore, ullishte, rezervuarë apo trupa të tjerë ujorë, si pjesë e sipërfaqeve të mësipërme, të destinuara për çlodhjen, argëtimin, aktivitetet ndërgjegjësuese dhe edukuese për publikun, turistët, apo individë të ndryshëm.

3. Territori që përbën kurorën e gjelbër është pronë e bashkisë dhe pjesë e planit të përgjithshëm vendor të saj.

**II. KRITERET DHE PROCEDURAT E
SHPALLJES SË KURORËS SË GJELBËR**

1. Shpallen “kurorë e gjelbër” sipërfaqet e përmendura në pikën 2, të kreut I, të këtij vendimi, që plotësojnë kriteret, si më poshtë vijojnë:

- a) kanë sipërfaqe që nuk kalon 20% të sipërfaqes së gjelbër të bashkisë;
- b) nuk janë të përfshira në rrjetin ekzistues kombëtar të zonave të mbrojtura mjedisore;
- c) kanë zhvillim të konsideruar pyjor, pemëtar apo të ullishtave, që plotëson masën e gjelbër të qyteteve;
- ç) janë të populluara me lloje të florës dhe të faunës, kryesisht të karakterit lokal;
- d) sigurojnë ruajtjen dhe konservimin e mjedisit natyror e të vlerave të biodiversitetit;
- dh) janë, kryesisht, zona natyrore, të pyllëzuara ose të kultivuara, ku mund të kryhen veprimtari të ndryshme rekreative;

e) nxisin ruajtjen e mjedisit, të peizazhit dhe mirëmbajtjen e integritetit ekologjik;

ë) ofrojnë përfitime në përtëritjen e shëndetit të njeriut dhe ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës urbane;

f) ofrojnë mundësi çlodhjeje për komunitetin, për veprimtari shoqërore, tradicionale, edukative, argëtuese, sportive, kulturore, turistike, zbavitjeje familjare, marrjen e ajrit të pastër, shëtitjen në natyrë.

2. Procesi i shpalljes së një kurorë të gjelbër inicohet nga njësi e vetëqeverisjes vendore (bashkia), kur janë siguruar burimet financiare dhe njerëzore-profesionale për këtë qëllim.

3. Procesi i shpalljes “kurorë e gjelbër” paraprihet nga propozimi, i cili kryhet brenda 6 (gjashtë) muajve, nga ndërmarrja e iniciativës për shpalljen e zonës “kurorë e gjelbër”, bazuar në procedurën, si më poshtë vijon:



a) propozimi, për sipërfaqen që planifikohet të shpallet “kurorë e gjelbër”, hartohet brenda 4 (katër) muajve, nëpërmjet bashkëpunimit të strukturave përkatëse të bashkisë me organet shtetërore vendore të interesuara, me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, shoqatat mjedisore vendore, institucionet kërkimore-shkencore, institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore dhe palë të tjera të interesuara;

b) propozimi përmban të dhëna për territorin që synohet të shpallet “kurorë e gjelbër”, vendndodhjen, kufijtë dhe objektivat e administrimit e të zhvillimit të synuar;

c) propozimi hartohet në përputhje me strategjitë sektoriale të veprimtarive që parashikohen të zhvillohen, planet e veprimit dhe programet e zhvillimit të bashkisë, planin e përgjithshëm vendor dhe kërkesat e Dokumentit Strategjik të Politikave për Mbrojtjen e Biodiversitetit në Shqipëri;

ç) propozimi publikohet në një vend të dukshëm në qendër të bashkisë, si dhe në një ose disa mjete tradicionale të informimit publik, për të cilin komuniteti, bizneset, OJF-të dhe të interesuarit bëjnë vërejtje e sugjerime që i paraqiten kryetarit të bashkisë. Kryetari i bashkisë organizon, të paktën, një dëgjese me publikun dhe gjithë procesi i publikimit dhe konsultimit përfundon brenda 2 (dy) muajve, nga publikimi i propozimit;

d) me përfundimin e këtij afati, duke marrë në konsideratë për aq sa është e mundur sugjerimet dhe komentet e bëra, bashkia, nëpërmjet një grupi pune, fillon përgatitjen e studimit, mbi bazën e të cilit do të realizohen procedurat për shpalljen e kurorës së gjelbër.

4. Studimi, mbi bazën e të cilit do të realizohen procedurat për shpalljen e kurorës së gjelbër, realizohet brenda 6 (gjashtë) muajve, nga një grup pune me përbërje ekspertësh të fushave kryesore, të OJF-ve, përfaqësues të administratës rajonale të zonave të mbrojtura dhe të ministrisë përgjegjëse për mjedisin. Kur në brendësi të territorit të propozuar për studim ndodhen pasuri kulturore, në grupin e punës përfshihen edhe ekspertë të fushës së trashëgimisë kulturore. Gjatë kësaj kohe, studimi shqyrtohet dhe merr miratimet përkatëse në strukturat përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore. Përbërja e grupit të punës

dhe drejtuesi i tij miratohen nga këshilli bashkiak, me propozimin e kryetarit të bashkisë.

5. Studimi i kryer nga grupi i punës mbështetet dhe përfshin:

a) grumbullimin e informacionit të nevojshëm, duke bashkëpunuar në vazhdimësi me strukturat bashkiake, institucionet qendrore, administratën rajonale të zonave të mbrojtura (AdRZM), banorët, shoqatat mjedisore, shkollat, si dhe rrethet shkencore apo akademike;

b) shqyrtimin e planit të përgjithshëm vendor, strategjitë sektoriale që parashikohen të zhvillohen, planet e veprimit, programet e zhvillimit të bashkisë, si dhe dokumentin strategjik të Politikave për Mbrojtjen e Biodiversitetit në Shqipëri;

c) ndërmarrjen e vëzhgimeve në terren, të cilat do të ndihmojnë në analizat e nevojshme për studimin e zonës mjedisore, të biodiversitetit e peizazhit, mjedisit në tërësi apo infrastrukturës, si dhe të modeleve të përgjithshme të zhvillimit social-ekonomik e turistik;

ç) argumentimin për krijimin e kurorës së gjelbër, propozimin e emrit të saj dhe objektivat e ruajtjes, të administrimit e menaxhimit të kurorës;

d) paraqitjen e rezultateve të procesit të këshillimit me komunitetin dhe grupet e interesuara, duke përfshirë komentet e bëra dhe reflektimin e propozimeve;

dh) paraqitjen e sipërfaqes së përgjithshme dhe kufijtë e zonës së propozuar “kurorë e gjelbër”, përshkrimin fizik e biologjik të sipërfaqes së propozuar dhe ndarjen sipas mbulesës së tokës;

e) paraqitjen e rëndësisë së habitateve, ekosistemeve, llojeve të florës e të faunës, vlerave historike e kulturore dhe të zonave ekoturistike;

ë) përshkrimin e masave e të investimeve që do të bëhen për mirëmbajtjen e kurorës së gjelbër;

f) paraqitjen e hartës së zonimit dhe koordinatat gjeografike të kufijve të sipërfaqes që do të propozohet kurorë e gjelbër.

6. Pas përfundimit të studimit dhe mbi bazën e tij, brenda 1 (një) muaji përgatitet nga strukturat përkatëse të bashkisë projektvendimi i Këshillit Bashkiak, që propozon shpalljen “kurorë e gjelbër”. Projektvendimi, së bashku me studimin, i cili është pjesë përbërëse e tij, shqyrtohet në mbledhjen e radhës së këshillit bashkiak.

7. Projektvendimi përmban emërtimin e kurorës së gjelbër, sipërfaqen e përgjithshme, kufijtë dhe hartën e zonimit, koordinatat gjeografike të



kufijve, si dhe objektivat e ruajtjes, të administrimit e menaxhimit të saj.

8. Vendimi që propozon shpalljen e kurorës së gjelbër, i miratuar nga këshilli bashkiak, brenda 30 ditëve i dërgohet për shqyrtim dhe miratim Këshillit Kombëtar të Territorit.

III. RREGULLAT DHE PËRGJEGJËSITË LIDHUR ME ADMINISTRIMIN, MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E KURORËS

1. AKZM-ja dhe drejtoria rajonale e zonave të mbrojtura, si organi lokal përgjegjës për zonat e mbrojtura, bashkëpunojnë me bashkinë për vendimmarrjet që lidhen me kurorën e gjelbër, ndërsa administrimi, mbrojtja dhe ruajtja e kurorës kryhen nga njësia përgjegjëse e mjedisit pranë bashkisë, në vijim njësia përgjegjëse.

2. Njësia përgjegjëse zbaton planin e menaxhimit të kurorës së gjelbër dhe zbaton masat, si më poshtë vijojnë:

a) përcakton vendet e vendosjes në terren të shenjave kufizuese, për të bërë shënimin e kufirit të kurorës së gjelbër;

b) përcakton formën e sinjalistikës së kurorës dhe vendet e vendosjes së tabelave, shenjave treguese e të shtigjeve të kalimit për vizitorët;

c) bën planifikimet e nevojshme lidhur me:

i. infrastrukturën e nevojshme në shërbim të vizitorëve të kurorës së gjelbër, si: stola, belvedere, çezma dhe shtigje të ndryshme;

ii. infrastrukturën për ngritjen e strukturave të shërbimeve shëndetësore e të nyjave sanitare dhe atyre të shërbimeve të tjera për vizitorët;

iii. zonat e veçanta për argëtim dhe veprimtari sportive;

iv. zonat e kufizuara për parkimin e mjeteve të ndryshme;

v. masat për rigjallërimin e pyjeve, të ripyllëzimit me lloje vendëse dhe dekorative, në përputhje me funksionet e kurorës së gjelbër.

ç) ndalon kryerjen e ndërhyrjeve dhe të veprimtarive në kurorë, të cilat nuk janë në përputhje me parashikimet e planit të menaxhimit;

d) merr masat e nevojshme për pezullimin apo kufizimin e të gjitha veprimtarive që cenojnë qëllimin dhe objektivat e menaxhimit;

dh) organizon kontrolle që evidentojnë gjendjen reale të kurorës gjelbër;

e) bashkëpunon dhe vë në dijeni strukturat përgjegjëse për inspektimin vendor, kur gjatë

veprimtarisë së saj konstaton mosrespektim të kërkesave ligjore;

ë) mban dhe plotëson regjistrin/skedarin e kurorës së gjelbër;

f) dokumenton veprimtaritë, investimet dhe kërkimet shkencore të kryera;

g) organizon, në bashkëpunim me strukturat të tjera, veprimtari ndërgjegjësuere për të bërë të njohura vlerat e kurorës gjelbër;

gj) bashkërendon veprimtaritë me palët e treta, si: shoqatat mjedisore, biznesin, vizitorët, kërkuesit shkencorë si dhe çdo palë tjetër të interesuar;

h) monitoron, në bashkëpunim me institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, edhe objektet kulturore, historike, arkitektonike dhe arkeologjike, që ndodhen brenda kurorës gjelbër.

3. Të gjithë masat dhe rregullat për njësinë përgjegjëse të kurorës së gjelbër, të paraqitura më lart, përfshihen në “Rregulloren e administrimit, të mbrojtjes dhe ruajtjes së kurorës së gjelbër”, e cila hartohet nga Drejtoria Rajonale e Zonave të Mbrojtura, në bashkëpunim me bashkinë, dhe miratohet nga drejtori i përgjithshëm Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, jo më vonë se 8 (tetë) muaj nga shpallja e kurorës së gjelbër. Kur në brendësi të kurorës së gjelbër ndodhen pasuri kulturore, rregullorja dërgohet për mendim pranë strukturave përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, e cila jep mendimet përkatëse, por pa cenuar kufijtë e miratuar të kurorës së gjelbër.

4. Për veprimtarinë e saj, lidhur me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës së gjelbër, njësia përgjegjëse informon rregullisht, por jo më pak se një herë në vit, kryetarin e bashkisë dhe këshillin bashkiak.

5. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 690, datë 23.10.2019

**PËR DHËNIEN ME QIRA, ME TARIFË
TË REDUKTUAR, TË SALLËS B, KATI 0
(UNDERGROUND) NË AMBIENTET E
PALLATIT TË KONGRESEVE,
KOMISIONIT TË JASHTËM
TË VLERËSIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 8, të kreut III, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për dhënie me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës B, kati 0 (*underground*), me sipërfaqe 243 (dyqind e dyzet e tre) m², të ndodhur në ambientet e Pallatit të Kongreseve, Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, me qëllim zhvillimin e seancave dëgjimore.

2. Tarifa e qirasë së sallës B, kati 0 (*underground*) do të jetë në masën ekuivalente të shpenzimeve operative të kryera respektivisht për çdo aktivitet, gjatë gjithë periudhës së dhënies me qira.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 691, datë 23.10.2019

**PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT
TË PASTRIMIT TË PARAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 3, të nenit 21, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Elvis Koçi emërohet drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 693, datë 2.10.2019

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 408, DATË 13.5.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË
ZHVILLIMIT TË TERRITORIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores së zhvillimit të territorit, bashkëlidhur vendimit nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, të



ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 19 bëhen këto shtesa dhe ndryshme:

1. Në pikën 3, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Objektet si dhe veprat e infrastrukturës brenda zonës së brezit bregdetar, të miratuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Këshilli Kombëtar i Territorit vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet e pikave 1 e 3, të këtij neni.”.

Neni 2

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, fjalët “... brenda 10 ditëve pune ...” zëvendësohen me “... brenda 20 ditëve pune ...”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Autoriteti përgjegjës vendos me procedurë të përshpejtuar, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e paraqitjes së aplikimit në sistemin e-leje, për pajisjen me leje ndërtimi, për ndërtimin, riparimin apo restaurimin e objekteve të dëmtuara, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile. Përjashtimisht, vetëm për këto raste:

a) aplikimet paraqiten për shqyrtim dhe miratim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve nga ana e Institutit të Ndërtimit;

b) dokumentacioni i vetëm që duhet të dorëzohet nga aplikuesi është:

i. raporti i hartuar nga komisioni apo struktura përkatëse e emergjencave civile, që vërteton shkaktimin e dëmit si pasojë e fatkeqësisë natyrore;

ii. projekti teknik/konstruktiv i hartuar nga Instituti i Ndërtimit.”.

Neni 3

Pas nenit 27/1 shtohet neni 27/2, me këtë përmbajtje:

“Neni 27/2

Dokumentet për pajisjen me certifikatë përdorimi

1. Dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë përdorimi janë, si më poshtë vijon:

a) kërkesa për certifikatë përdorimi, sipas formatit të aplikimit të përcaktuar në sistemin e-leje, e nënshkruar elektronikisht;

b) autorizim me prokurë nga zhvilluesi për aplikantin (nëse zhvilluesi dhe aplikuesi janë subjekte të ndryshme), ose autorizim i pajisur me nënshkrim elektronik nëse aplikuesi është subjekt shtetëror;

c) procesverbali i kolaudimit, i hartuar nga kolaudatori/grupi i kolaudimit, i shoqëruar me licencën/licencat përkatëse, brenda afatit të vlefshmërisë;

ç) deklarata e përputhshmërisë nga subjekti/subjektet që kanë kryer punimet;

d) Relacioni teknik i mbikëqyrësit/mbikëqyrësve, mbi zbatimin e të gjitha disiplinave të punimeve të ndërtimit, shoqëruar nga licencat përkatëse, brenda afatit të vlefshmërisë;

dh) aktet e kontrollit të fazave të ndërtimit ose akti përmbledhës për të gjitha fazat e kontrollit;

e) situacioni përfundimtar i punimeve;

ë) aktet përkatëse (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.), të lëshuara nga shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a., Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe ato për menaxhimin e mbetjeve urbane;

f) leja e ndërtimit shoqëruar me planvendosjen e miratuar;

g) projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti “as build” (i zbatuar);

gj) “Projekti për mirëmbajtjen e objektit”, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve;

h) certifikimi i montimit të ashensorëve dhe inspektimi final;

i) policën e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar;

j) fotografi të objektit në të gjitha orientimet;



k) kontrata e nënshkruar ndërmjet zhvilluesit dhe shoqërisë/shoqërive ndërtuese, shoqëruar me licencën përkatëse;

l) kontrata e nënshkruar, ndërmjet zhvilluesit dhe mbikëqyrësit/mbikëqyrësve të punimeve, shoqëruar me licencën përkatëse.

2. Për rastet e zhvillimeve komplekse në kompetencë të KKT-së, sekretariati teknik i KKT-së mund të përcaktojë dokumente shtesë nga ato të përmendura në pikën 1, të këtij neni, në varësi të objektit për të cilin kërkohet certifikata e përdorimit.”.

Neni 4

Shtojca “C”, e vendimit nr.408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën “C”, bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 5

Kudo në këtë rregullore, emërtimet “Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” dhe “Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme” zëvendësohen me “Agjencia Shtetërore e Kadastrës” dhe “Drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore e Kadastrës”.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA C



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA _____/KKT

LEJE NDËRTIMI

Nr. __, datë __. __. ____

I JEPET:

ZHVILLUESIT:

I REGJISTRUAR SI SUBJEKT ME TË DHËNAT E MËPOSHTME:

LEJA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE:

AFATI KOHOR I KËSAJ LEJE ËSHTË:

Pronat që zhvillohen	
Treguesit teknike	



Leja e ndërtimit jepet me këto kushte:

1. të respektohet destinacioni i zhvillimit për ndërtimin e strukturës, si dhe treguesit e zhvillimit;
2. të respektohet radha e punimeve sipas projektit të miratuar dhe grafikut të punimeve;
3. të rrethohet zona ku ndërtohet dhe të mbahet pastër ambienti përreth;
4. për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike sipas projektit të miratuar të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen shqetësime në rrjetin publik;
5. të respektohen normat dhe standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi kryerjen e punimeve dhe sigurinë në punë;
6. gjatë zbatimit të punimeve objekti do të kontrollohet nga autoritetet e kontrollit të zhvillimit dhe inspektorati përkatës në fushën e ndërtimit;
7. në shkëlqje të kushteve ligjore të kësaj leje do të merren masa konform ligjit deri në prishje të saj;
8. afati i fillimit të punimeve është 1 (një) vit nga data e lëshimit të kësaj leje;
9. kjo leje është e vlefshme për një periudhë ____ mujore nga data e fillimit të punimeve sipas grafikut të punive.

Data e miratimit të lejes

Kryetar Bashkie / Sekretar i KKT-së

VENDIM

Nr. 694, datë 2.10.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 686, DATË 22.11.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores së planifikimit të territorit, bashkëlidhur vendimit nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijojnë:

Neni 1

Në nenin 2, pas pikës 15, shtohet pika 15/1 me këtë përmbajtje:

“15/1 “Konsolidim urban”, është procesi i densifikimit dhe i mbushjes urbane të njësisë strukturore apo të një a më shumë pjesëve të saj, të cilat janë të zhvilluara në mënyrë homogjene, sa u

përket kushteve të zhvillimit, ndërtimeve në territor, si dhe rrjetit rrugor e infrastrukturor.”.

Neni 2

Pika 1 e nenit 11, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Rishikimi i dokumentit të planifikimit kryhet në përputhje me nenin 26, të ligjit, për shkak të forcave madhore, si: tërmete, përmbajtje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion etj., të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale, si edhe kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.”.

Neni 3

Pika 1, e nenit 22, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Planet kombëtare sektoriale hartohen nga ministritë, me qëllim zhvillimin strategjik të një ose më shumë sektorëve, sipas fushave të kompetencës, si:

a) siguria kombëtare;

b) mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore, të lidhura me: sizmiticitetin, hidrogeologjinë, hidrografinë, gjeologjiko-inxhinierinë, ndryshimet klimatike etj.;



- c) energjia;
- ç) industria;
- d) transporti;
- dh) infrastruktura;
- e) turizmi;
- ë) zonat detare dhe infrastruktura e ujit;
- f) zonat ekonomike;
- g) arsimi;
- gj) sporti;
- h) trashëgimia kulturore dhe natyrore;
- i) burimet natyrore;
- j) shëndetësia;
- k) bujqësia etj.”.

Neni 4

Shkronja “P”, e pikës 2, të nenit 82, ndryshohet si më poshtë vijon:

“f) zhvillimet në zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore, tërmete, përmytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion etj.”.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 6, datë 17.5.2019

**PËR PROCEDURAT QË NDIQEN PËR
ADMINISTRIMIN E AUTOMJETEVE
DHE MOTOMJETEVE QË KALOJNË NË
REZERVAT MATERIALE TË SHETIT,
SI PASOJË E KONFISKIMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të neneve 203, 209 dhe 211, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, të neneve 2, 4/“c”, 6, 10 dhe 11, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, të ndryshuar, si dhe të pikës 2/“b”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 5.8.2008, “Për krijimin dhe

administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”; dhe të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme nr. 1, datë 9.1.2019, “Për procedurat e kalimit të automjeteve dhe motomjeteve nga mjediset e drejtorive vendore të Policisë së Shtetit dhe ato të Policisë Kufitare dhe të migracionit, te drejtoritë rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit”, me qëllim që të ketë unifikim në procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit, si pasojë e konfiskimit,

UDHËZIJ:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit është përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme për pranimin dhe marrjen në dorëzim të automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit, si pasojë e konfiskimit.

2. Mjetet e konfiskuara kategorizohen duke përcaktuar peshën reale të tyre, nga një komision i ngritur nga ana e drejtorit të përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit. Komisionet për kategorizimin përbëhen nga jo më pak se 5 anëtarë, nga të cilët 3 nga DPRMSH-ja dhe 2 nga FA-ja dhe në përbërjen e tyre marrin pjesë detyrimisht specialistë të fushës (inxhinierë mekanikë etj.). Anëtarët nga FA-ja caktohen nga SHSHPFA-ja me kërkesë të drejtorit të DPRMSH-së. Kur këta specialistë nuk mund të sigurohen nga strukturat përkatëse, atëherë mund të punësohen ekspertët të jashtëm me kontratë, sipas procedurave ligjore.

Komisioni për kategorizimin e mjeteve, duke marrë për bazë këto kritere: viti i prodhimit, kilometrat e përshkruar, gjendja teknike e motorit, normat e harxhimit të karburantit për 100 km, gjendja teknike e pjesëve xhenerike, sistemin elektrik, pamja e jashtme e mjetit dhe tapicerinë, norma e emetimit të gazrave, kategorizon mjetet, si më poshtë:

a) mjete që plotësojnë kushtet teknike për qarkullim;

b) mjete që do të administrohen në skrap, duke përcaktuar njëkohësisht edhe peshën fizike respektive.



Për mjetet e marra në dorëzim *de jure*, komisioni për kategorizimin e realizon veprimtarinë në pikën ekzistuese të ruajtjes së mjeteve.

Për efekt kontabiliteti, mjetet e konfiskuara, pas marrjes në dorëzim nga drejtoritë e Rezervave Materiale të Shtetit, do të kontabilizohen me vlerën 1 (një) lek.

3. Komisioni i kategorizimit, për përcaktimin e peshës reale fizike të mjeteve që do të administrohen në skrap, vepron si më poshtë:

a) përcakton peshën bosh të mjetit, sipas librezës teknike, pllakatës metalike apo faqes zyrtare të internetit, që përmbajnë të dhënat për peshën e mjeteve;

b) bën një klasifikim të mjeteve:

- nga 3.5 tonë deri në 10 tonë;
- kamionçinë deri në 3.5 tonë;
- furgon dhe fuoristradë;
- autoveturë;
- motoçikletë;

c) peshës teknike bosh i zbret peshën që përfshin: xhamat, pjesët plastike të kroskotit, sediljet, tapiceritë, gomat, parakolpi, stopat, fenerët etj., që, për shkak të natyrës, nuk përfshihen në kategorinë e skrapeve, sipas klasifikimit të mjeteve.

Komisioni i kategorizimit, për përcaktimin e peshës reale fizike të mjeteve, zbret peshën sipas shkronjës “c”, të pikës 3, të këtij udhëzimi, mbi bazën e një manuali të hartuar nga një grup specifik pune dhe të miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes. Në këtë manual do të përcaktohen edhe përqindjet e metaleve me ngjyrë për secilën kategori të mjeteve motorike, të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 3. Grupi i punës, për hartimin e këtij manuali do të ketë në përbërje 5 anëtarë, specialistë të fushës (inxhinierë mekanikë, inxhinierë elektrikë, financiarë etj.) dhe ekspertë vlerësues të jashtëm dhe të pavarur, të përzgjedhur sipas procedurave ligjore. Grupi i punës, brenda 30 ditëve nga marrja e detyrave paraqet manualin për miratim te ministri i Mbrojtjes.

4. Pas kategorizimit, DPRMSH-ja i dërgon Zyrës Qendrore Kombëtare të Interpol Tiranë listën e mjeteve të kategorizuara për qarkullim me numrat e shasisë për konfirmim, nëse mjeti është në kërkim. Në rast se mjetet nuk rezultojnë në kërkim, u nënshtrohen procedurave të shitjes me ankand publik. Në rast se mjetet rezultojnë në kërkim, vijnë gjendje pranë Rezervave të Shtetit për procedura të mëtejshme.

5. Ministri miraton strukturën përgjegjëse dhe nisjen e procedurave të shitjes me ankand të mjeteve të konfiskuara.

6. Mjetet e kategorizuara sipas pikës 2/“b” të këtij udhëzimi, u shiten vetëm shoqërive me objekt veprimtarie: mbledhje dhe përpunim skrap. Me qëllim që autoriteti shitës të sigurohet për tjetërsimin për skrap (shkatërrimin/demolimin e mjeteve objekt ankandit), strukturat përgjegjëse për zhvillimin e ankandit, bazuar në ligjin dhe rregullat e ankandit publik, të parashikojnë në kushtet e veçanta të kontratës klauzola për verifikimin e zbatimit të kontratës, në përputhje me objektin e saj dhe në zbatim të detyrimeve mjedisore që rrjedhin nga politikat mjedisore në Ministrinë e Mbrojtjes.

Çmimi i shitjes përcaktohet për kilogram skrap, sipas përqindjes së metaleve që përmban çdo mjet, sipas manualit të përmendur në pikën 3 të këtij udhëzimi dhe sipas legjislacionit në fuqi mbi ankandin publik.

7. Lista e mjeteve që plotësojnë kushtet teknike për qarkullim, që do të shiten me ankand, sipas legjislacionit në fuqi mbi ankandin publik, së bashku me të dhënat përkatëse, për vitin e prodhimit, markën dhe modelin, me qëllim përlllogaritjen e vlerës fillestare të shitjes, i dërgohet nga struktura përgjegjëse për zhvillimin e ankandit, zyrës doganore më të afërt, e cila përdor si burim informacioni buletinët që pasqyrojnë çmimet e shitjes në tregjet evropiane. Të ardhurat kalojnë në buxhetin e shtetit.

8. Mjetet që plotësojnë kushtet teknike për qarkullim, të cilat u janë nënshtuar procedurave të shitjes me ankand publik dhe procedurat e ankandit kanë dështuar, të trajtohen për skrap.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, pas përfundimit të procedurave të ankandit, njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor me listë zyrtare për heqjen nga qarkullimi dhe çregjistrimin e tyre.

10. Mjetet e kaluara në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 203 i Kodit Rrugor, shiten duke i trajtuar si mjetet e konfiskuara.

Për këtë rast, në përfundim të procedurave të shitjes, struktura përgjegjëse për zhvillimin e ankandit njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vlerën e realizuar nga shitja



me ankand. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në rast se pas shitjes së mjetit:

- evidenton diferencë të mundshme në lekë, ia kthen atë shkelësit;

- evidenton se vlera e shitjes rezulton më e ulët se vlera e gjobës, atëherë vlera e shitjes konsiderohet e ardhur përfundimtare në buxhetin e shtetit dhe kryen sistemimin e veprimeve dokumentare dhe të rakordimit të kontabilitetit.

11. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, për zbatimin e këtij udhëzimi.

12. Përgjigjet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Olta Xhačka

UDHËZIM
Nr. 24, datë 21.10.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 5, DATË 19.2.2018, “PËR
PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE
PËRBËRËSE TË RAPORTIMIT VJETOR
DHE AFATIT PËR RAPORTIM TË
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT
TË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 32, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 5, datë 19.2.2018, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, fjalia e parë e pikës 3 ndryshon si më poshtë:

“Raporti vjetor dërgohet nga IAL-ja, zyrtarisht, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në 1 (një) kopje origjinale, në formë të shkruar dhe/ose elektronike, brenda muajit dhjetor të çdo viti.”

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE
RINISË
Besa Shahini

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 651, datë 13.9.2019

**PËR PROCEDURAT E RAPORTIMIT, TË
RASTEVE TË FËMIJËVE NË NEVOJË,
PËR MBROJTJE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 7, të nenit 67, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e të fëmijës”, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Brendshëm dhe ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

UDHËZOJNË:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave të raportimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, nga çdo person fizik ose juridik, institucionet publike dhe private, mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psikosocial në shkollë, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes shoqërore të fëmijës, publike apo private, organet e policisë dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës, në nivel vendor, sipas përcaktimeve në ligjin nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” (në vijim “ligji”).

2. Personat fizikë ose juridikë, të përmendur në pikën 1 të këtij udhëzimi, kanë detyrimin ligjor të raportojnë pranë organeve të Policisë së Shtetit ose strukturave për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor, për çdo rast të dyshuar apo të ndodhur të abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit apo shfrytëzimit të fëmijës.



3. Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në njësitë e vetëqeverisjes vendore, marrin masa për vendosjen e njoftimeve me informacionin e kontaktit në të gjitha institucionet publike apo private të përkujdesjes shoqërore për fëmijët, të arsimit e të shëndetësisë, strukturat e policisë dhe personat juridikë, publikë dhe privatë, për të lehtësuar raportimin.

4. Njoftimi me informacionin e kontaktit duhet të përmbajë:

a) strukturat ku mund të raportohet dhe adresat përkatëse;

b) numrin e telefonit në dispozicion dhe adresat e *email*-it;

c) informacion që raportimi mund të bëhet në çdo kohë;

ç) informacion që të gjithë personat, të cilët kanë detyrim për raportim, kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale;

d) informacion që punonjësit e çdo strukture, të cilët marrin raportimin dhe ata që do të ndjekin çështjen e raportuar, kanë detyrimin për të ruajtur anonimatën dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU II

PROCEDURAT E RAPORTIMIT DHE DOKUMENTACIONI

1. Pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, çdo person fizik ose juridik, si dhe çdo punonjës i institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën për shkak të profesionit, duhet të bëjë raportimin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës ose pranë organeve të Policisë së Shtetit.

2. Çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijët, për shkak të profesionit dhe ka dyshim se një fëmijë abuzohet, neglizhohet, keqtrajtohet apo ndodhet në rrezik për diçka të tillë, duhet të njoftojë menjëherë organet e Policisë së Shtetit ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.

3. Mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psikosocial shkollor dhe oficerët e sigurisë, për ato insitucione të arsimit parauniversitar, ku janë emëruar, kanë për detyrë të referojnë në drejtorinë e shkollës, çdo rast të dyshuar apo të ndodhur abuzimi, neglizhimi, dhune apo shfrytëzimi të fëmijës. Drejtuesit e shkollës kanë për detyrë ta referojnë rastin pranë

institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të cilat e referojnë rastin menjëherë pranë strukturave vendore për mbrojtjen e fëmijëve.

4. Punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike ose private, kanë për detyrë të raportojnë menjëherë te drejtori i institucionit, organet e Policisë së Shtetit, strukturat për mbrojtjen e fëmijës, çdo rast të dyshuar apo të ndodhur të abuzimit, keqtrajtimit, braktisjes, neglizhimit apo dhunës te fëmijët.

5. Punonjësit e policisë pranë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, përveç marrjes së masave për trajtimin dhe marrjen në mbrojtje të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të rasteve të njoftuara nga punonjësit/profesionistët, përgjatë përmbushjes së detyrave funksionale të tyre, identifikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe kryejnë procedurën për raportimin e rastit te strukturat vendore për mbrojtjen e fëmijës.

6. Profesionistët e përmendur në nenin 67, të ligjit 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” ose struktura përgjegjëse pranë institucionit, raportojnë menjëherë, duke kontaktuar punonjësin e strukturave të Policisë së Shtetit apo të strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës, me çdo mjet komunikimi, telefon, *email*, me postë, në formë shkresore, rastet që identifikohen si në rrezik të menjëhershëm apo të lartë, ndërsa, rastet e tjera të rrezikut, të mesëm apo të ulët, raportohen brenda 24 orëve nga identifikimi.

7. Raportimi bëhet nëpërmjet formularit të raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje të përcaktuar në aneksin 2, vendimin nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

8. Formulari i plotësuar dërgohet në mënyrë elektronike apo me postë te punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, përgjegjës për territorin ku është bërë identifikimi i rastit. Në formular hidhet i gjithë informacioni dhe të gjitha detajet e ditura nga personi apo personat, të cilët janë në dijeni dhe kanë raportuar rastin.

9. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe punonjësit e strukturave vendore të Policisë së



Shtetit, shënojnë në një regjistër të veçantë të emërtuar: “Regjistri i raportimeve të rasteve të fëmijëve”, të gjitha rastet e raportuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Regjistri duhet të përmbajë:

a) orën dhe datën e raportimit;

b) të dhëna për raportuesin;

c) gjeneralitetet e fëmijës;

ç) vendndodhjen e fëmijës;

d) emrin apo të dhëna për personin, i cili dyshohet se ka abuzuar, neglizhuar, shfrytëzuar apo keqtrajtuar fëmijën;

dh) institucionin publik apo privat ku ndodhet fëmija;

e) kualifikimi i ngjarjes së identifikuar dhe lloji i dhunës;

ë) cilës strukturë i është drejtuar çështja për ndjekje.

10. Regjistri i raportimeve të rasteve të fëmijëve krijohet, administrohet, ruhet dhe arkivohet, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.

11. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës me marrjen e raportimit dhe regjistrimin e tij në regjistër, ka detyrimin të ndërmarrë të gjitha masat e veprimet e nevojshme për verifikimin e informacionit të dhënë dhe fillimin ose jo të vlerësimit fillestar të rastit.

12. Punonjësit e strukturave vendore të Policisë së Shtetit, me marrjen e raportimit dhe regjistrimin në regjistër, kanë detyrimin të referojnë rastin në kohë të punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, përgjegjës për territorin ku është bërë identifikimi i rastit, si dhe të bashkëpunojë me punonjësin për mbrojtjen e fëmijës, sipas nevojave të identifikuara gjatë procesit të menaxhimit të rastit.

KREU III

RREGULLA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DHE KONFIDENCIALITETIN E ÇËSHTJES

1. Të gjithë personat fizikë ose juridikë të përmendur në kreun I, pikën 1 të këtij udhëzimi, të cilët kanë detyrim për raportim, kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale të rasteve të raportuara, sipas detyrimeve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Punonjësit e çdo strukture, të cilët marrin raportimin dhe ata që do të ndjekin çështjen e raportuar, kanë detyrimin për të ruajtur konfidencialitetin e çështjes dhe mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijës dhe të personit të dyshuar për abuzim.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Çdo mospërmbushje e detyrimit ligjor për raportimin e rastit nga personat fizikë ose juridikë, të përmendur në kreun I, pikën 1 të këtij udhëzimi, konsiderohet kundërvajtje administrative, sipas nenit 69, të ligjit nr. 18/2017.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, strukturat për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE
RINISË

Besa Shahini

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

RREGULLORE

Nr. 2, datë 24.10.2019

PËR ORGANIZIMIN E TREGJEVE TË PRODUKTEVE TË PESHKIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, shkronjës “g”, të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, dhe pikës 9, të kreut I, të VKM nr. 464, datë 3.7.2019 “Për procedurat për shitjen e parë të produkteve të peshkimit”, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, miraton rregulloren si më poshtë,



KREU I TË PËRGJITHSHME

1. Kjo rregullore përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregjeve të shitjes me shumicë të produkteve të peshkimit.

2. Menaxhuesi i tregut të shitjes me shumicë mund të jetë Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës ose Organizata e Peshkimit ose Njësia e Vetëqeverisjes Vendore. Në një treg të shitjes me shumicë ushtrojnë veprimtaritë e tyre dhe organet shtetërore, si Inspektorati i Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, struktura të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe organe të tjera që kanë lidhje me funksionimin normal të një tregu të shitjes me shumicë.

3. Tregjet e shitjes me shumicë janë struktura me interes publik, qëllimi i të cilit është promovimi i marketingut të produkteve me qëllim që të sigurohet shpejtësia dhe efikasiteti i përgjithshëm i rishpërndarjes së prodhimeve të peshkimit, zhvillimi i profesionalizmit sipërmarrës, mbrojtja e komponentëve më të dobët të prodhimit dhe të tregtisë, duke lidhur konsumin me prodhimin, duke garantuar zinxhirin e tregtimit, për të ulur kostot e përgjithshme.

KREU II MENAXHIMI I TREGUT TË SHITJES ME SHUMICË

1. Për menaxhimin e tregut të shitjes me shumicë krijohet Komiteti Këshillimor i tregut të shitjes me shumicë me mandat tre vjeçar. Anëtarët e Komitetit kanë të drejtë të rizgjidhen.

2. Në rastet kur menaxhimi kryhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, Komiteti Këshillimor i tregut të shitjes me shumicë drejtohet nga kryetari i Bashkisë, i cili luan rolin e kryetarit dhe ka në përbërje:

- a) dy anëtarë të këshillit bashkiak nga të cilët njëri është përfaqësues i pakicës;
- b) dy përfaqësues të pronarëve të anijeve të peshkimit, njëri përfaqësues i peshkimit tregtar industrial dhe tjetri përfaqësues i peshkimit tregtar artizanal, bregdetar;
- c) një përfaqësues i tregtarëve me shumicë;
- d) një përfaqësues i tregtarëve me pakicë;
- e) një përfaqësues i industrisë përpunuese;
- f) Inspektori i Peshkimit;

g) Inspektori i Drejtorisë së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;

h) një përfaqësues i kapitanerisë së porteve;

i) një përfaqësues i të punësuarve në tregun e shitjes me shumicë;

j) një përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

3. Në rastet kur menaxhimi kryhet nga organizatat, Komiteti Këshillimor i tregut të shitjes me shumicë drejtohet nga kryetari/presidenti i organizatës, i cili luan rolin e kryetarit dhe ka në përbërje:

a) dy anëtarë të organizatës, përfaqësues të pronarëve të anijeve të peshkimit, njëri përfaqësues i peshkimit tregtar industrial dhe tjetri përfaqësues i peshkimit tregtar artizanal, bregdetar;

b) një përfaqësues i tregtarëve me shumicë;

c) një përfaqësues i tregtarëve me pakicë;

d) një përfaqësues i industrisë përpunuese;

e) Inspektori i Peshkimit;

f) Inspektori i Drejtorisë së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;

g) një përfaqësues i kapitanerisë së porteve;

h) një përfaqësues i të punësuarve në tregun e shitjes me shumicë;

i) një përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

4. Në rastet kur menaxhimi kryhet nga institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës, Komiteti Këshillimor i tregut të shitjes me shumicë drejtohet nga titullari i saj, ose një përfaqësues i autorizuar, i cili luan rolin e kryetarit dhe ka në përbërje:

a) dy përfaqësues nga Sektori i Menaxhimit të Porteve të Peshkimit: përgjegjësi i sektorit dhe përfaqësuesi lokal;

b) një ekonomist;

c) dy anëtarë të organizatës, përfaqësues të pronarëve të anijeve të peshkimit, njëri përfaqësues i peshkimit tregtar industrial dhe tjetri përfaqësues i peshkimit tregtar artizanal, bregdetar;

d) një përfaqësues i tregtarëve me shumicë;

e) një përfaqësues i tregtarëve me pakicë;

f) një përfaqësues i industrisë përpunuese;

g) Inspektori i Peshkimit;

h) Inspektori i Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;

i) një përfaqësues i kapitanerisë së porteve;

j) një përfaqësues i të punësuarve në tregun e shitjes me shumicë.



5. Komiteti Këshillimor i tregut mbledhet nga kryetari sa herë që e sheh të nevojshme ose me kërkesë të bërë nga një e treta e anëtarëve.

Njoftimet e takimit, me rendin e ditës, dërgohen tek anëtarët të paktën shtatë ditë para datës së mbledhjes, pa paragjykuar asnjë kërkesë urgjente që dërgohet njoftim 24 orë nga çdo mjet i vlefshëm komunikimi.

6. Në punimet e Komitetit Këshillimor mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, ekspertë për çështjet që do të shqyrtohen ose përfaqësues të grupeve të tjera të interesit.

Njoftimet e takimit, me rendin e ditës, dërgohen tek anëtarët të paktën shtatë ditë para datës

së mbledhjes, pa paragjykuar asnjë kërkesë urgjente që dërgohet njoftim 24 orë nga çdo mjet i vlefshëm komunikimi.

7. Mbledhjet quhen të vlefshme kur në të marrin pjesë 50% + 1 të anëtarëve të tij.

8. Anëtarët e Komitetit të cilët mungojnë për tri mbledhje rresht, pa arsye, humbasin mandatin.

9. Vendimet merren me shumicë votash dhe në rast barazimi, vota e kryetarit është përcaktuese.

10. Menaxhuesi i tregut vendos në mënyrë të pavarur mbi propozimet e Komitetit Këshillimor.

11. Detyrat e Komitetit Këshillimor, janë:

a) të propozojë ndryshime dhe përmirësime për pajisjet dhe shërbimet e tregut, në mënyrë që të sigurohet produktiviteti maksimal dhe përmirësimi i efikasitetit funksional përfshirë edhe sigurinë ushqimore;

b) të shprehë mendimin e tij për:

i. oraret e funksionimit të tregut të shitjes me shumicë;

ii. kriteret për ndarjen e vendeve të blerjes;

iii. tarifatat për dhënien me qira të frigoriferëve;

iv. tarifatat e shërbimeve të tregut të shitjes me shumicë;

v. rregulloren e tregut, duke sugjeruar edhe ndryshime;

vi. organizimin e personelit të nevojshëm për funksionimin e shërbimeve të tregut dhe për çdo ndryshim të këtij organizimi;

vii. çdo çështje tjetër lidhur me aktivitetet në tregun e shitjes me shumicë.

12. Pjesëmarrja në Komitetin Këshillimor të tregut të shitjes me shumicë është pa shpërblim.

KREU III DREJTORI I TREGUT

1. Drejtori i tregut emërohet dhe shkarkohet nga menaxhuesi i tregut, me propozim të Komitetit Këshillimor. Ai zgjidhet nga radhët e profesionistëve të fushave të peshkimit dhe akuakulturës, drejtësisë dhe ekonomisë, me eksperiencë pune të paktën 5 vjet në profesion.

2. Drejtori është përgjegjës për funksionimin e rregullt të tregut dhe shërbimeve, organizimi i të cilit do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai drejton, mbikëqyr dhe cakton detyrat për secilin punonjës, cakton turnet dhe orët e punës.

3. Drejtori i tregut kryhen detyrat e mëposhtme:

a) konstaton plotësimin e kushteve për pjesëmarrjen në procedurën e ankandit;

b) mbikëqyr kohën e hapjes dhe mbylljes së tregut;

c) siguron që operacionet e furnizimit të tregut të mos pengohen;

d) siguron që të gjitha transaksionet e blerjes dhe shitjes janë kryer sipas ligjeve dhe rregulloreve;

e) autorizon në raste të jashtëzakonshme futjen dhe daljen e produkteve ushqimore përtej kohës së caktuar;

f) propozon, me sugjerimin e operatorëve, nismat që synojnë favorizimin e furnizimit të tregut me produkte, zgjerimin e sipërfaqes së nevojshme për shitje;

g) verifikon faktin që mallrat dhe ambalazhet përputhen me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

h) verifikon, me kërkesë të palëve të interesuara ose kryesisht, cilësinë e produktit dhe dokumentacionin shoqërues;

i) është përgjegjës për përmbushjen e të gjithë detyrave të lënë nga inspektori i ngarkuar për inspektimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit në treg;

j) siguron mospërdorimin e praktikave mashtruese lidhur me peshën e produktit apo të çdo praktike tjetër që mund të përdoret nga tregtarët;

k) rregullon inspektimet gjatë orarit të mbylljes së tregut dhe veçanërisht natën;

l) në raste urgjente, merr masat e nevojshme për të cilat raporton te menaxheri i tregut;



m) siguron pajisjet e duhura për të mundësuar ruajtjen e mallrave në treg;

n) miraton akte brenda përgjegjësi të tij, në funksion të mirë organizimit të tregut;

o) siguron që veprimtaria e tregtareve të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi;

p) kujdeset për ushtrimin e kontrollit veterinar dhe higjeno-sanitar të produkteve të peshkimit në përputhje me legjislacionin në fuqi;

q) kujdeset për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë zhvillimit të ankandit. Brenda 30 ditëve nga lindja e mosmarrëveshjes palët e interesuar kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, pranë drejtorit të tregut. Drejtori, brenda 30 ditëve, shqyrton pretendimet e tyre dhe vendos mbi to.

KREU IV SHËRBIMET

1. Shërbimi i ngarkimit/shkarkimit ofrohet prej tregut të shitjes me shumicë, kundrejt pagesës së tarifës, përveç rasteve kur ky shërbim mbulohet nga shitësi. Tregu i shitjes me shumicë ruhet nga punonjës shërbimi ose nga shoqëri private të sigurisë fizike për gjatë zhvillimit të procedurës së ankandit.

2. Tregu i shitjes me shumicë ofron dhënien me qira të frigoriferëve, kundrejt pagimit të tarifës. Çdo subjekt që dëshiron marrjen me qira të frigoriferëve i drejton kërkesë drejtorit të tregut.

3. Në tregun e shitjes me shumicë funksionon shërbimi i arkës i cili kryhet nga një bankë e nivelit të dytë me detyrë ofrimin e shërbimeve për kryerjen e veprimet të pagesave midis operatorëve të tregut ndërmjet tyre, si dhe të operatorëve.

4. Drejtori i tregut me shumicë, pas njoftimit të arkës, pezullon të gjitha transaksionet e blerjeve nga operatorët debitorë.

5. Shërbimet që ofron tregu me punonjësit e vetë ose nëpërmjet të tretëve janë si më poshtë:

- a) shërbimi i pastrimit të tregut;
- b) shërbimi i furnizimit me akull;
- c) shërbimi i arkës;
- d) shërbimi i ruajtjes;
- e) çdo shërbim tjetër ndihmës në treg.

6. Zhvillimi i ankandit sigurohet nga shitësi.

Ngarkohet Ministria përgjegjëse për peshkimin për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

SEKSIONI I DYTË

ÇËSHTJA PRIZRENI KUNDËR SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 29309/16)

VENDIM

STRASBURG

11 qershor 2019

Ky vendim është bërë i formës së prerë, bazuar në nenin 44 § 2 të Konventës.

Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Prizreni kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i dytë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Robert Spano, kryetar,

Marko Bošnjak,

Işıl Karakaş,

Julia Laffranque,

Valeriu Griţco,

Amfinn Bårdsen,

Darian Pavli, gjyqtarë dhe Stanley Naismith, sekretar i seksionit,

pasi diskutuan me dyer të mbyllura në datën 21 maj 2019,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë.

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një kërkesë (nr. 29309/16) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në gjykatë, në datën 16 maj 2016, mbështetur në nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), nga një shtetas shqiptar, z. Fatos Prizreni (kërkuesi).



2. Kërkuesi u përfaqësua nga znj. E. Skendaj, nga Komiteti i Helsinkit. Qeveria shqiptare (qeveria) u përfaqësua nga agjenti i saj, znj. Alma Hicka nga Avokatura e Shtetit.

3. Kërkuesi u ankua për mungesë të një hetimi efikas për vdekjen e vëllait të tij, teksa ishte duke vuajtur dënimin me burgim, në kundërshtim me nenin 2 të Konventës. Gjithashtu, ai u ankua për trajtimin çnjerëzor dhe degradues ndaj vëllait të tij, si rezultat i mungesës së trajtimit mjekësor dhe faktit se vëllai i tij kishte qenë i prangosur teksa ishte në spital, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.

4. Në datën 4 tetor 2016, qeveria u njoftua për ankesat në lidhje me mungesën e pretenduar për një hetim efikas për vdekjen e vëllait të kërkuesit, teksa ai po vuante një dënim me burgim, si edhe për një trajtim të pretenduar çnjerëzor dhe degradues si rezultat i mungesës së trajtimit mjekësor dhe faktit se kishte qenë në pranga ndërsa ishte në spital. Pjesa tjetër e kërkesës u shpall e papranueshme sipas rregullës 54 § 3 të Rregullores së gjykatës.

FAKTET

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Kërkuesi ka lindur në vitin 1963 dhe jeton në Elbasan, Shqipëri. Ai është vëllai i SH.P., lindur në vitin 1973. SH.P. vdiq më 22 shkurt 2011.

A. Vdekja e vëllait të kërkuesit

2. Më 29 mars 2010, Gjykata e Rrethit Shkodër dënoi SH.P. me katër vjet burg për vrasje të mbetur në tentativë. Procesi u zhvillua *in absentia*. Më 2 dhjetor 2010, Gjykata e Apelit Shkodër la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Shkodër. Më 3 shkurt 2011, vendimi i fundit u ekzekutua dhe SH.P. u dërgua të vuante dënimin në institucionin e paraburgimit Lezhë.

7. Nga dosja e çështjes rezulton se SH.P. u diagnostikua nga doktori i institucionit të paraburgimit Lezhë me parapanesis inferior (paralizë e pjesshme e të dyja këmbëve) dhe elephantiasis (filariasi limfatik). Më 9 shkurt 2011, SH.P. u transferua në mënyrë urgjente në Qendrën Spitalore të Burgjeve, Tiranë, sepse sipas doktorit në institucionin e paraburgimit Lezhë, ai nuk mund të trajtohej në mënyrën e duhur në një burg të zakonshëm. Më 17 shkurt 2011, ai u transferua në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë. Nga dosja spitalore e datës 17 shkurt 2011, rezulton se vëllai i kërkuesit është diagnostikuar me elephantiasis,

obezitet morbid dhe pamjaftueshmëri të shumëfishtë në organe, dhe iu përcaktuan mjekimet.

8. Rezulton se më 22 shkurt 2011, SH.P. vdiq në njësinë e kujdesit intensiv në Spitalin Universitar Tiranë.

B. Veprimet hetimore

9. Në datën 22 shkurt 2011, një grup i përbërë nga një oficer i policisë gjyqësore, një kriminalist dhe një ekspert mjekoligjor, realizoi kryerjen e vendit të ngjarjes në Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës, dhe kryerjen e kufomës së SH.P., si edhe bëri fotografi në skenën e krimin. Në po të njëjtën ditë, oficeri i policisë gjyqësore sekuestroi kartelën klinike të SH.P., e cila mbahej në Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës.

10. Më 22 shkurt 2011, oficeri i policisë gjyqësore, i ngarkuar me çështjen, urdhëroi një këqyrje mjekoligjore të SH.P. dhe i paraqiti pyetjet më poshtë ekspertëve mjekoligjorë:

“1. Çfarë dëmtimesh ishin të dukshme tek i ndjeri?

2. Çfarë i kishte shkaktuar ato?

3. Cili ishte shkaku i vdekjes së tij?

4. A kishte qenë ai subjekt i një trajtimi mjekësor neglizhent?”

11. Më 22 shkurt 2011, kërkuesi u mor në pyetje si personi me dijeni për ngjarjen. Ai pohoi se pjesëtarët e familjes së tij e kishin informuar se vëllai i tij po dërgohej në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale Lezhë. Më 17 shkurt 2011, nëna i kishte thënë se vëllai i tij ishte sëmurë dhe po transferohej në spitalin e Tiranës. Kur kishte mbërritur në spital, e kishte gjetur vëllanë pa ndjenja dhe të lidhur në krevat me çarçafë. Ai kishte vënë re se dysheku dhe batanijet ishin të lagura dhe se zona rreth krevatit ishte shumë e pistë. Rreth orës gjashtë të mëngjesit, më 22 shkurt 2011, motra e tij e kishte telefonuar për t'i thënë se situata e vëllait të tyre ishte përkeqësuar. Kur kishte mbërritur në spital, e kishte gjetur vëllanë të vdekur. Si shtoi se donte të dinte shkakun e vdekjes së vëllait të tij.

12. Më 25 shkurt 2011, oficeri i policisë gjyqësore, përgjegjës, kontrollloi regjistrin e shkrimeve në Spitalin e Burgut Tiranë, ku ishte regjistruar se SH.P., ishte transferuar në atë godinë, më 9 shkurt 2011.

13. Më 9 mars 2011 dhe përsëri më 25 mars 2011, Prokuroria e Tiranës kërkoi dosjen e SH.P.



nga mjedisi i paraburgimit Lezhë. Më 21 mars 2011, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë u përgjigj me anë të një shkrese, ku deklaronte se kërkuesi vuante nga dispnea, pjesët e poshtme të dy gjymtyrëve të tij kishin edemë dhe, se për këtë arsye, ai ishte transferuar me urgjencë në Spitalin e Burgut Tiranë. Gjithashtu, ata bashkëngjitën dosjen e burgut të SH.P.

14. Më 10 mars 2011, prokurori përgjegjës për çështjen urdhëroi një sërë veprimesh hetimore të cilat do të realizoheshin nga një oficer i policisë gjyqësore:

“1. Të kontaktohen ekspertët mjekoligjorë, të cilët do të kryenin një kontroll mjekoligjor për të gjetur shkakun e vdekjes së të ndjerit; 2. Të sekuestrohet dosja penale dhe kartela mjekësore e SH.P. nga ambientet e burgimit, si edhe nga spitali; 3. Të kontrollohet në regjistrat e Spitalit të Burgut Tiranës, Spitalit Universitar Tiranë dhe të spitalit civil Shkodër, për të zbuluar se kur është pranuar në spital, cila ka qenë diagnoza, sa kohë ka qëndruar atje etj., faqet e regjistratit të cilat janë relevante për kërkimin duhet t'i bashkëngjiten raportit; 4. Të merren në pyetje punonjësit e burgut të Tiranës, stafi mjekësor, i cili është kujdesur për SH.P. dhe anëtarët e familjes së tij për historikun e tij mjekësor, trajtimin e tij, kur është pranuar në spital për herë të fundit etj.; dhe 5. Të realizohen veprime të tjera të cilat mund të vlerësohen si të nevojshme përpara datës 29 mars 2011.”

15. Më 25 mars 2011, I.O., një nga doktorët që është kujdesur për vëllanë e kërkuesit në spital, i pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore, pohoi se teksa ishte nën mbikëqyrjen e tyre, SH.P. ishte diagnostikuar me pamjaftueshmëri të shumëfishtë dhe obezitet morbid. SH.P. ishte trajtuar si çdo pacient tjetër dhe trajtimi me mjekime dhënë në receta ishte administruar në përputhje me rregullat.

16. Më 25 mars 2011, P.D., një nga doktorët i cili ishte kujdesur për vëllanë e kërkuesit në spital, i pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore, pohoi se SH.P. ishte transferuar në Spitalin e Burgut Tiranë nga Spitali i Burgut Lezhë. Ai ishte trajtuar si çdo pacient tjetër dhe trajtimi i dhënë në receta ishte administruar në përputhje me rregullat.

17. Më 30 mars 2011, një grup ekspertësh mjekoligjorë ekzaminuan SH.P. Raporti mjekoligjor deklaronte, se *inter alia*:

“1. Në të dy parakrahët u vunë re ekimoza. Edema në ekstremitetet e poshtme. Psoriasis ...

2. Ekimoza e shkaktuar nga sende të mprehta. Pjesa tjetër e dëmtimeve janë pasojë e sëmundjeve të tjera të të ndjerit ...

3. Në gjakun e SH.P. nuk u gjendën gjurmë të mjekimeve ose të substancave narkotike ose psikotrope ...

4. Vdekja e SH.P. ishte pasojë e pamjaftueshmërisë akute kardiorespiratore, për shkak të komplikacioneve të sëmundjes së përgjithshme metabolike ...

5. Në lidhje me pyetjen, nëse trajtimi mjekësor i SH.P. ishte neglizhuar, ky do të jetë subjekti i një kërkimi tjetër nga komisioni mjekoligjor, sapo këta të fundit të kenë dosjen hetuese në dispozicion ...”

C. Pjesa e parë e procedimeve

18. Më 24 shkurt 2011, policia raportoi vdekjen e SH.P. në Prokurorinë e Tiranës, e cila e regjistroi në dosjen penale. Pasi u kryen veprimet hetimore, më 13 prill 2011, Prokuroria e Tiranës vendosi mosfillimin e procedimit penal dhe të njoftonte palët e interesuara për atë vendim. Vendimi u mbështet në raportin mjekësor të datës 30 mars 2011, në të cilin u konstatohet se vdekja e SH.P. ishte rezultat i një pamjaftueshmërie akute respiratore dhe kardiake, si edhe e sëmundjeve të tjera. Gjithashtu, në vendim deklarohet se nuk ekzistonte asnjë fakt, e dhënë ose tregues se mund të ishte kryer një vepër penale. Më 13 maj 2011, kërkuesit iu njoftua vendimi i Prokurorisë së Tiranës.

19. Më 17 maj 2011, kërkuesi paraqiti një ankesë në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ndaj vendimit të prokurorisë së Tiranës. Më 20 tetor 2011, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi ankesën e kërkuesit me argumentin se ai nuk kishte pozita ligjore të ankohej ndaj vendimit të kundërshtuar, sepse ai ishte njoftuar në lidhje me të si familjar i të ndjerit. Edhe Gjykata e Shkallës së Parë deklaroi, se, sipas nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, vetëm personat të cilët kishin denoncuar një vepër penale mund të ankoheshin për një vendim për mosfillim të procedimit penal.

20. Më 20 prill 2012, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë të datës 20 tetor 2011. Më 23 janar 2014, Gjykata e Lartë kundërshtoi apelimin e paraqitur nga kërkuesi. Më 17 nëntor 2015, Gjykata Kushtetuese kundërshtoi ankesat e kërkuesit ndaj vendimeve të gjykatave vendëse, me argumentin se mohimi i statusit të pozicionit për të kundërshtuar vendimin



e prokurorit nuk shkelte thelbin e së drejtës së kërkuesit për të pasur akses në gjykatë.

D. Pjesa e dytë e procedimeve

21. Më 16 shkurt 2015, kërkuesi raportoi vdekjen e vëllait të tij në Prokurorinë e Tiranës. Më 27 mars 2015, Prokuroria e Tiranës vendosi mosfillimin e procedimit penal mbështetur në kallëzimin e kërkuesit. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesi paraqiti një ankesë në Gjykatën e Rrethit Tiranë në lidhje me vendimin e sipërpërmendur. Më 18 nëntor 2015, Gjykata e Rrethit Tiranë, në referim të pjesës së parë të procedimeve dhe të provave të përdorura në ato procedime, pa dëgjuar ankuesin, vendosi të kundërshtonte ankesën e tij.

II. LIGJI PËRKATËS VENDËS

A. Kushtetuta e Shqipërisë

22. Neni 21 i Kushtetutës parashikon se jeta e çdokujt mbrohet me ligj. Neni 25 parashikon se asnjë nuk mund t'i nënshtrohet torturës apo dënimit, ose trajtimit të ashpër, çnjerëzor ose degradues.

B. Kodi i Procedurës Penale (KPP)

23. Dispozitat përkatëse të KPP-së parashikojnë, në momentin në fjalë, si më poshtë:

“Neni 58

Të drejtat e personit të dëmtuar nga vepra penale

1. Personi i dëmtuar nga veprat penale ose trashëgimtarët e tij, kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit.

2. Personi i dëmtuar që nuk ka zotësi juridike për të vepruar i ushtron të drejtat që i janë njohur me ligj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të tij.

3. I dëmtuari ka të drejtë të parashtojë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojë marrjen e provave. Kur kërkesa e tij nuk pranohet nga prokurori, ai ka të drejtë të ankohet në gjykatë, brenda 5 ditëve nga marrja e saj.

Neni 59

I dëmtuari akuzues

1. Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112, paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149 dhe 254 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si

palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

2. Prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.

3. Nëse i dëmtuari akuzues ose mbrojtësi i caktuar prej tij nuk paraqitet në seancë pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos pushimin e gjykimit.

Neni 290

Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit

1. Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur:

a) personi ka vdekur;

b) personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale;

c) mungon ankimi i të dëmtuarit ose ai e tërheq ankimin;

ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston;

d) vepra penale është shuar;

dh) është dhënë amnistia;

e) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 291

Vendimi për mosfillimin e procedimit

1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit.

2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit.

Neni 329

Ankimi kundër vendimit të pushimit të çështjes

1. Kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri.

2. Gjykata, kur e gjen të drejtë ankimin e të dëmtuarit vendos që hetimet të vazhdojnë, ndërsa kur pranon ankimin e të pandehurit ndryshon



vendimin e pushimit me formulim më të favorshëm për të pandehurin.

3. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit nga prokurori, i dëmtuari dhe i pandehuri.”

LIGJI

I. KUNDËRSHTIMI PARAPRAK I QEVERISË

Shterimi i mjeteve të brendshme dhe rregulla e gjashtë muajsh

1. Parashtrimet e qeverisë

24. Qeveria parashtroi se kërkuesi nuk kishte shfrytëzuar mjetet e brendshme, sepse rruga ligjore që ai kishte zgjedhur të ndiqte ishte e gabuar. Edhe nëse do të supozohej se ai kishte shteruar mjetet e brendshme në dispozicionin e tij, sipas këndvështrimit të qeverisë, ai e kishte dorëzuar kërkesën në gjykatë, jashtë afatit gjashtëmuajsh, sipas vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 23 janar 2014 dhe faktit se atij nuk i ishte kërkuar që të shfrytëzonte apelin në Gjykatën Kushtetuese.

25. Sipas qeverisë, në lidhje me pjesën e parë të procedimeve, kërkuesi kishte qenë pasiv dhe nuk e kishte kallëzuar kurrë çështjen në prokurori. Të gjitha gjykatat vendëse kishin arsyetuar rregullisht se sipas nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, ai nuk mund të ishte palë në ato procedime, sepse ato nuk kishin filluar prej tij. Kishte mjete të tjera të disponueshme në sistemin e brendshëm, të cilat mund të ishin përdorur. Neni 58 i Kodit të Procedurës Penale i mundësonte palët e dëmtuara ose trashëgimtarët e tyre të kërkonin fillimin e procedimeve penale ndaj autorit të krimit dhe të kërkonin kompensim.

26. Në lidhje me pjesën e dytë të procedimeve (shih paragrafin 21 më sipër), edhe pse ato u filluan në bazë të një ankesës së re të kërkuesit në prokurori dhe çuan në një apelim dorëzuar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ai nuk e kishte ndjekur çështjen më larg se sa Gjykata e Shkallës së Parë. Për këtë arsye, qeveria parashtroi se ankesat e kërkuesit duhet të kundërshtoheshin si të papranueshme, duke qenë se nuk ishin shteruar mjetet e brendshme.

2. Parashtrimet e kërkuesit

27. Kërkuesi parashtroi se ai kishte shteruar mjetet e brendshme të disponueshme për të dhe se e kishte paraqitur ankesën në gjykatë, brenda afatit të parashikuar në nenin 35, paragrafi 1. Në lidhje

me këtë gjë, ai iu referua praktikës gjyqësore, me një theks të veçantë në qasjen e gjykatës për zbatimin e rregullës së shterimit të mjeteve të brendshme, me një shkallë fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepërt. Kërkuesi parashtroi se ai i kishte kërkuar zyrtarisht oficerit të policisë gjyqësore, i cili ishte përgjegjës për të hetuar mbi vdekjen e vëllait të tij, të kryente një hetim për sqarimin e rrethanave të vdekjes së vëllait të tij. Kjo përbënte një kërkesë formale për t'i konsideruar akuzat, në përputhje me nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, fakti se vëllai i tij kishte vdekur përmbante *ipso facto* një detyrim për autoritetet, sipas nenit 2 të Konventës për të kryer një hetim efikas.

28. Në lidhje me pjesën e dytë të procedimeve, kërkuesi deklaroi se ai kishte vendosur të mos paraqiste një apelim në Gjykatën e Apelit ose në Gjykatën e Lartë, sepse nuk do të kishte asnjë mundësi për sukses, duke qenë se gjykata do ta kishte marrë çështjen në konsideratë vetëm pasi ajo do të vinte prej pjesës së parë të procedimeve.

3. Vlerësimi i gjykatës

29. Fillimisht, gjykata do të adresojë kundërshtimin e qeverisë, se kërkesa u dorëzua pasi kishte kaluar afati kohor prej gjashtë muajsh. Tashmë, gjykata, e mendimit se në rastet në lidhje me hetimin për keqtrajtim, ashtu si në ato në lidhje me një hetim për vdekjen e dyshimtë të një të afërmi, kërkuesit priten të ndërmarrin hapa për të ndjekur progresin e hetimit ose mungesën e tij, si edhe të paraqesin kërkesat e tyre në mënyrë të rregullt, sapo ata bëhen me dije ose duhet të ishin bërë me dije, për mungesën e një hetimi penal efikas (shih *Mocanu dhe të Tjerët kundër Rumanisë* [DHM], nr. 10865/09 dhe 2 të tjerë, § 263 GJEDN] 2014 (ekstrakte).

30. Në çështjen në fjalë, gjykata vëren se kërkuesi e kundërshtoi vendimin e prokurorit për mosfillim të një hetimi penal formal për vdekjen e vëllait të tij deri në Gjykatën Kushtetuese, duke luajtur në këtë mënyrë një rol aktiv në proces. Një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për shkeljet e pretenduara për një gjykim të drejtë është një mjet i cili normalisht duhet të shterohet (shih *Xheraj kundër Shqipërisë*, nr. 37959/02, § 43, 29 korrik 2008; *Beshiri dhe të Tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 7352/03, § 32, 22 gusht 2006 dhe *Balliu kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 74727/01, 16 qershor 2005). Kërkesa, mbështetur në garancitë kushtetuese vendëse për



një proces të rregullt dhe aksesin në gjykatë, u vlerësua e pranueshme dhe u shqyrtua nga Gjykata Kushtetuese për cilësitë e saj.

31. Kërkuesi paraqiti kërkesën në gjykatë më 16 maj 2016, kohë e cila është 5 muaj dhe 29 ditë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Për këtë arsye, gjykata rrëzon kundërshtimin e qeverisë, se ankesa u paraqit përtej afatit.

32. Në lidhje me kundërshtimin e dytë, në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme, gjykata vëren se kërkuesi i kërkoi oficerit të policisë gjyqësore, të ngarkuar për çështjen e vëllait të tij, të hetonte rrethanat e vdekjes së këtij të fundit (shih paragrafin 11 më sipër). Gjithashtu, ai kundërshtoi vendimin e prokurorit të Tiranës për mosfillim të procedimit penal deri në nivel të Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafët 18–20).

33. Pyetja, nëse kërkuesit i duhej t'i ishte kërkuar të sillte një ankesë penale të veçantë në lidhje me rrethanat e vdekjes së vëllait të tij, lidhet ngushtë me cilësitë e ankesave të tij për nenin 2 dhe nenin 3. Në këtë rrethanë, gjykata është e mendimit se ky kundërshtim duhet të shqyrtohet së bashku me cilësitë e asaj ankese (shih paragrafët 44–45 më poshtë).

II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 2 TË KONVENTËS

34. Kërkuesi u ankua se autoritetet nuk kishin realizuar një hetim efikas për vdekjen e vëllait të tij, sipas parashikimit të nenit 2 të Konventës, e cila parashikon si më poshtë:

“1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.”

Nëse autoritet kryen një hetim efikas

1. Parashtrimet e palëve

35. Kërkuesi parashtroi se hetimi i kryer nga autoritetet nuk ofronte informacione të kënaqshme për rrethanat në lidhje me vdekjen e vëllait të tij. Ai nuk përjashtonte, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se dëmtimi shëndetësor i përshkruar në raportin mjekësor nuk ishte shkaktuar për arsye të keqtrajtimit të vëllait të tij dhe/ose mungesës së ndihmës së duhur mjekësore. Ekspertët mjekoligjorë, të cilët kishin kryer ekzaminimin mjekësor nuk kishin adresuar pyetjen e oficerit të policë gjyqësore, për faktin nëse trajtimi mjekësor i vëllait të kërkuesit kishte qenë i papërshtatshëm.

Përkundrazi, ata kishin gjykuar se kjo gjë mbetej të verifikohet nga një tjetër komision. Gjithashtu, veprimet hetimore të kryera nuk ofronin një shpjegim bindës për mungesën e ndonjë gjurme mjekimi në gjakun e kërkuesit dhe se kjo nuk i atribuohet trajtimit të papërshtatshëm.

36. Për më tepër, kërkuesi iu referua parimeve që vinin prej praktikës gjyqësore të gjykatës në lidhje me mbrojtjen e parashikuar në nenin 2 të Konventës, për personat e ndaluar dhe në një pozicion të cënueshëm. Sipas kërkuesit, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të kësaj çështje, një ekzaminim mjekoligjor i detajuar ishte thelbësor për të përcaktuar shkaktuesin e vdekjes dhe për të verifikuar nëse kishte pasur shenja keqtrajtimi.

37. Qeveria parashtroi se autoritetet kishin kryer një hetim efikas për vdekjen e SH.P. Prokurori kishte urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore (shih paragrafin 14 më sipër). Veçanërisht, qeveria i tërhoqi vëmendjen gjykatës në përfundimet e raportit mjekoligjor, i cili konstatoi se vdekja e SH.P. ishte shkaktuar nga një pamjaftueshmëri respiratore dhe kardiake, si rezultat i historisë së tij mjekësore.

38. Në vijim, qeveria parashtroi se stafi mjekoligjor e kishte mbajtur SH.P. në mbikëqyrje të vazhdueshme. Kjo provohej nga kartelat mjekësore të konfiskuara gjatë veprimeve hetimore. Për këtë arsye, autoritetet vendëse kishin marrë të gjitha masat e nevojshme për të ruajtur jetën e SH.P. Vdekja e tij kishte ardhur si pasojë e rrethanave përtej kontrollit të autoriteteve.

2. Vlerësimi i gjykatës

a) Parime të përgjithshme

39. Gjykata përsërit se neni 2 i Konventës, i cili garanton të drejtën për të jetuar, renditet si një nga parashikimet më themelore në Konventë. Në mbështetje të rëndësisë së mbrojtjes, parashikuar në nenin 2, gjykata duhet të shqyrtojë me kujdesin më të madh ankesat për privimin e jetës (shih *McCann dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Madhe*, 27 shtator 1995, §§ 146–47, seritë A nr. 324, dhe *Nachova dhe të Tjerët kundër Bullgarisë* [DHM], nr. 43577/98 dhe 43579/98, § 93, GJEDNJ 2005-VII).

40. Detyrimi për të mbrojtur jetën, sipas nenit 2 të Konventës, i lexuar në lidhje me detyrën e përgjithshme të shtetit, sipas nenit 1 të Konventës: “për të siguruar çdonjërin brenda juridiksionit [të saj] të drejtat dhe liritë e përcaktuara në



Kushtetutë”, kërkon edhe sipas nënkuptimit se duhet të ketë një lloj hetimi efikas zyrtar në rastin kur individët janë vrarë si rezultat i përdorimit të forcës (shih *Nachova dhe të Tjerët kundër Bullgarisë* [DHM], cituar më sipër). Në vijim, gjykata deklaron, se kurdo që një i ndaluar vdes në rrethana të dyshimta, neni 2 u kërkon autoriteteve të kryejnë një hetim të pavarur dhe të paanshëm zyrtar, i cili përmbush standarde minimale të caktuara për efikasitetin (shih *Trubnikov kundër Rusisë*, nr. 49790/99, §§ 87-88, 5 korrik 2005).

41. Në vijim, në kontekstin e kujdesit për shëndetin, gjykata ka interpretuar detyrimin procedural të nenit 2, duke iu kërkuar shteteve të ngrenë një sistem efikas dhe të pavarur gjyqësor, në mënyrë që shkaku i vdekjes së pacientëve nën kujdesin mjekësor, qoftë në sektorin publik apo në atë privat, mund të përcaktohet dhe të vihen përpara llogaridhënies personat përgjegjës (shih *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë* [DHM], nr. 56080/13, § 214, 19 dhjetor 2017, dhe *Šilih kundër Sllovenisë* [DHM], nr. 71463/01, § 192, 9 prill 2009).

42. Një hetim duhet të jetë efikas në kuptimin që ai mund të çojë në përcaktimin e fakteve dhe, aty ku është me vend, të kryhet identifikimi dhe dënimi i personave përgjegjës. Edhe pse nuk është detyrim i rezultatit por i mjeteve, çdo deficiencë në hetime, të cilat dëmtojnë mundësinë për të përcaktuar rrethanat e çështjes ose personin përgjegjës, rrezikon të ketë parregullsi me standardin e kërkuar të efikasitetit (shih *Al-Skeini dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 55721/07, §§ 166, GJEDNJ 2011). Autoritetet duhet të veprojnë me pushtetin e tyre sapo çështja kalon në vëmendjen e tyre. Ato nuk mund ta lënë atë në iniciativën e të afërmit as për të paraqitur një ankesë formale ose për të kërkuar linja të posaçme hetimesh ose procedurash hetimesh (shih *Nachova dhe të Tjerët kundër Bullgarisë* [DHM], nr. 43577/98 dhe 43579/98, § 111, GJEDNJ 2005-VII). Në të gjitha rastet, i afërmi i viktimës duhet të përfshihet në procedurë në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tij/saj legjitimë (shih *Mustafayev kundër Azerbajxhanit*, nr. 47095/09, § 72, 4 maj 2017).

43. Kërkesa për gatishmëri dhe për adresim të arsyeshëm është e nënkuptuar në këtë kontekst (shih *Sidika Imrem kundër Turqisë*, nr. 47384/11, § 59, 13 shtator 2016). Duhet të pranohet se mund të ketë pengesa ose vështirësi të cilat pengojnë

progresin në hetim në një situatë të caktuar. Megjithatë, një përgjigje e menjëhershme nga autoritetet në hetimin e vdekjeve të dyshimta mund të konsiderohet në përgjithësi si thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut në mbështetje të shtetit të së drejtës dhe në parandalimit të çdo forme të marrëveshjeve të fshehta ose tolerancës ndaj akteve të paligjshme (shih *Merkulova kundër Ukrainës*, nr. 21454/04, § 50, 3 mars 2011, dhe *Armani da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 5878/08, § 237, 30 mars 2016).

b) Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen në fjalë

44. Fillimisht, gjykata do të adresojë parashtrimin e qeverisë, të cilin e ka bashkuar me cilësitë e çështjes, sipas së cilave kërkuuesi ka pasur një qëndrim pasiv, duke mos e raportuar çështjen në prokurori (shih paragrafin 25 dhe paragrafin 33 më sipër).

45. Siç është theksuar më sipër, autoritetet duhet të veprojnë me kompetencën e tyre, në momentin që një çështje kalon në vëmendjen e tyre (shih paragrafin 40 më sipër). Për pasojë, mbetet e pamaterializuar nëse vetë kërkuuesi mori një rol aktiv në përfshirjen e autoriteteve hetuese.

46. Në lidhje me detajet e hetimit të realizuar, gjykata vëren se hetimi për vdekjen e SH.P. filloi në mënyrën e duhur, në ditën e vdekjes së tij, me një ekzaminim në skenë, një ekzaminim të trupit të të ndjerit dhe konfiskimin e kartelës mjekësore (shih paragrafin 9 më sipër). Për më tepër, më 10 mars 2011, Prokuroria e Tiranës urdhëroi një sërë veprimesh hetimore (shih paragrafin 14 më sipër).

47. Më tej, gjykata vëren se ekzaminimi mjekoligjor i SH.P., i realizuar më 30 mars 2011, konstatoi se ai kishte vdekur si rezultat i pamjaftueshmërisë akute respiratore dhe kardiake, për shkak të komplikacioneve të sëmundjes së tij të përgjithshme metabolike. Gjithashtu, u konstatua se nuk ka gjurmë mjekimesh në gjakun e tij. Kartela mjekësore e SH.P., nga ana tjetër, tregonte se atij i ishin bërë një sërë mjekimesh, sipas përshkrimit të stafit mjekësor (shih paragrafin 7 më sipër).

48. Sidoqoftë, gjykata vëren disa mungesa të veçanta në veprimet hetimore të ndërmarra nga autoritetet vendëse.

49. Fillimisht, ka një mospërputhje midis informacionit të regjistruar në kartelën mjekësore, ku tregohet se vëllait të kërkuetit i janë dhënë mjekime dhe ekzaminimit mjekoligjor të datës 30



mars 2011, në lidhje me trajtimin mjekësor të SH.P. Veprimet hetimore të realizuara, nuk përcaktojnë nëse SH.P. kë qenë nën mjekim përpara vdekjes së tij dhe, nëse po, nëse ai ka qenë mjekimi i duhur, duke marrë parasysh historikun e tij mjekësor (shih paragrafin 17 më sipër). Për këtë arsye, gjykata nuk është e bindur nëse përcaktohet përtej çdo dyshimi të arsyeshem se vdekja e SH.P. ka ardhur si rezultat i sëmundjes së tij dhe jo për shkak të trajtimit dhe kujdesit të papërshtatshëm. Gjithashtu, hetimi nuk adreson pretendimet për prangosjen e vëllait të kërkuesit gjatë qëndrimit të tij në spital dhe, nëse një masë e tillë ka çuar në vdekjen e tij, duke marrë në konsideratë, veçanërisht, natyrën e kushteve të tij mjekësore.

50. Së dyti, gjykata vëren se vendimi i prokurorisë së datës 13 prill 2011, për mosfillimin e një hetimi, është marrë kryesisht mbështetur në të njëjtin ekzaminim mjekësor. Përcaktimi se ekzaminimi mjekësor nuk jep përgjigje për disa pyetje thelbësore, më konkretisht, nëse është ofruar trajtimi i duhur mjekësor dhe nëse kushtet e kërkuesit në spital kanë çuar në vdekjen e tij, gjykata nuk është e bindur me vendimin marrë nga Prokuroria e Tiranës për mosngritje të akuzave apo edhe për moshapjen formale të një hetimi penal; është në respektim të detyrimit procedural parashikuar në nenin 2 të Konventës.

51. Së treti, gjykata vëren se pavarësisht përpjekjeve të kërkuesit për ta kundërshtuar atë vendim, ankesat e tij u rrëzuan nga gjykatat vendëse (shih paragrafët 18–21 më sipër). Gjykata edhe një herë përsërit se i afërmi i viktimës duhet të përfshihet në procedurë deri në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tij/saj legjitime (shih *Mustafajev kundër Azerbajxhanit*, cituar më sipër, § 72). Gjykata, në shumë raste, ka theksuar se përfshirja e të afërmit të shërben për të garantuar llogaridhënien publike të autoriteteve dhe kontrollin publik të veprimeve të tyre gjatë hetimit. E drejta e familjes së të ndjerit, vdekja e të cilit është nën hetim, për të marrë pjesë në procedime, kërkon që procedura e miratuar të garantojë mbrojtjen e nevojshme të interesit të tyre, i cili mund të jetë në konflikt të drejtpërdrejtë me interesin e policisë ose forcave të sigurisë të përfshirë në ngjarje (shih *Anusca kundër Moldavisë*, inr. 24034/07, § 44, 18 maj 2010). Pamundësia statutoe në çështjen në fjalë, në mënyrë që kërkuesi të kundërshtojë në mënyrë efikase

vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimeve penale, nuk është në linjë me detyrimin e shtetit për të kryer një hetim efektiv.

52. Në këtë mënyrë, gjykata rrëzon kundërshtimin paraprak të qeverisë. Mangësitë e përshkruara më sipër, e çojnë gjykatën në konkluzionin se autoritetet vendëse nuk kanë kryer një hetim të përshtatshëm dhe efikas në rrethanat që kanë të bëjnë me vdekjen e vëllait të kërkuesit. Për këtë arsye, ka pasur një shkelje të detyrimit procedural shtetëror, sipas nenit 2, për të mbrojtur të drejtën për të jetuar.

III. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 3 TË KONVENTËS

53. Kërkuesi u ankua se teksa ishte i ndaluar, vëllai i tij i është nënshtruar një forme trajtimi e cila është në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve, ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.”

54. Gjithashtu, kërkuesi pretendonte se ai e kishte gjetur vëllanë e tij në spital të lidhur me çarçafë, teksa ishte pa ndjenja dhe se shenjat në kyçet e duarve të vëllait të tij ngrinin dyshime serioze se ai kishte qenë i prangosur ndërsa ishte në spital. Gjithashtu, rezultati i ekzaminimit mjekoligjor, në të cilin tregohet një mungesë mjekimesh në gjak, ngrinte dyshime nëse ai kishte marrë kujdesin e duhur mjekësor. Në lidhje me këtë gjë nuk u bënë hetime të tjera, pavarësisht një nënvizimi në raportin e ekzaminimit mjekoligjor se çështja duhej të hetohej më tej.

55. Qeveria kundërshtoi parashtrimin e kërkuesit. Ajo argumentoi se dosja hetimore tregonte se ishin marrë në konsideratë të gjitha masat, nëse vëllai i kërkuesit i ishte nënshtruar një keqtrajtimi. Provat tregonin se ai ishte mbajtur nën mbikëqyrje të vazhdueshme mjekësore. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit se vëllai i tij ishte prangosur, Qeveria parashtrroi se një gjë e tillë nuk mbështetej në prova.

56. Gjykata ka konstatuar se autoritetet nuk kanë përcaktuar në mënyrë të prerë shkakun e vdekjes së SH.P. Gjithashtu, autoritetet nuk kanë dhënë një shpjegim të fortë në lidhje me dy të nxirat e gjetura në kyçet e duarve të SH.P. dhe se nuk ka asnjë tregues se policia e burgut ose personeli i spitalit janë marrë në pyetje në lidhje me këtë çështje. Deklaratat e kërkuesit për policinë, së



bashku me gjetjet e raportit mjekoligjor për të nxirat e konstatuara në trupin e vëllait të tij, çojnë në pretendimin e diskutueshëm se vëllai i kërkuesit mund të ketë qenë subjekt i një trajtimi, i cili vjen në kundërshtim me nenin 3, gjatë kohës që ishte në spital, duke nënvizuar kështu detyrimin e autoriteteve për të hetuar çështjen (*Bouyid kundër Belgjikës* [DHM], nr. 23380/09, § 92, GJEDNJ 2015).

57. Gjykata përsërit se prangosja nuk ngre domosdoshmërisht një problematikë, sipas nenit 3 të Konventës, për aq kohë sa masa është ushtruar në lidhje me ndalimin e ligjshëm dhe nuk përbën përdorim të forcës apo ekspozim publik, i cili tejkalon atë çfarë konsiderohet në mënyrë të arsyeshme si e nevojshme. Në këtë aspekt, është e rëndësishme të merret në konsideratë, për shembull, nëse ka rrezik nëse personi në fjalë mund t'i fshihej drejtësisë ose të shkaktonte dëmtime ose dëme (shih *Tarariyeva kundër Rusisë*, nr. 4353/03, § 109, GJEDNJ 2006-XV (ekstrakte). Në çështjen në fjalë, raporti mjekoligjor thjesht përmendte ekzistencën e shenjave dhe faktin se ato ishin shkaktuar nga një objekt i mprehtë në trupin e vëllait të kërkuesit. Megjithatë, autoritetet nuk kanë bërë hetime të mëtejshme në lidhje me faktin nëse vëllai i kërkuesit i është nënshtruar ndonjë forme keqtrajtimi (shih paragrafin 17 më sipër). Për më tepër, në lidhje me këtë aspekt nuk u bënë hetime të mëtejshme. Në këtë mënyrë, gjykata konstaton se autoritetet vendëse nuk kanë marrë mjaftueshëm masa hetimore për të përcaktuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, nëse të nxirat në kyçet e duarve të vëllait të kërkuesit ishin shkaktuar nga trajtimi, i cili bie në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Në këto rrethana, gjykata e ka të pamundur të arrijë në përfundimin nëse ka pasur një shkelje të qartë të nenit 3.

58. Në analizën përfundimtare, gjykata merr në konsideratë se autoritetet nuk kanë mundur të kryejnë një hetim efikas për të përcaktuar nëse vëllai i kërkuesit ka qenë subjekt i keqtrajtimit teksa ishte i ndaluar. Në këtë mënyrë, në lidhje me këtë aspekt, ka pasur një shkelje të nenit 3 të Konventës, sipas aspektit të tij procedural.

IV. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME NENET 2 DHE 3 TË KONVENTËS

59. Në vijim, kërkuesi u ankua se në sistemin vendës nuk ka asnjë mjet efikas për ankesat e tij në

mbështetje të neneve 2 dhe 3 të Konventës. Ai mbështetet në nenin 13 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

60. Kërkuesi pretendonte se edhe pse ai kishte paraqitur një ankesë ndaj vendimit të prokurorisë së Tiranës për mosfillimin e procedimit penal, Gjykata e Rrethit Tiranë e kishte kundërshtuar atë. Ai e kishte ndjekur rrugën deri në Gjykatën Kushtetuese, por pa asnjë rezultat. Ky është një tregues se mjetet që ai ka përdorur nuk kanë qenë efikase dhe se ai nuk ka pasur asnjë mjet tjetër të cilin sot ë mund ta kishte përdorur.

61. Qeveria e kundërshtoi këtë argument. Ajo pretendonte se kërkuesi kishte pasur mjete efikase në dispozicion të tij, por ai kishte zgjedhur të ndiqte rrugën e gabuar procedurale (shih paragrafët 19–21 më sipër).

62. Gjykata vëren se kjo ankesë ka të bëjë me të njëjtat problematika si ato të shqyrtuara në nenet 2 dhe 3 të Konventës. Për këtë arsye, ankesa duhet të deklarohet e pranueshme. Megjithatë, në lidhje me përfundimet e saj më sipër, sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës, gjykata e konsideron si të panevojshme shqyrtimin e këtyre çështjeve më veçantë, sipas nenit 13 të Konventës.

V. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

63. Neni 41 i Konventës parashikon se:

“Kur gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

64. Kërkuesi pretendonte 30 000 euro (EUR) për dëmin jomonetar të vuajtur nga ai dhe vëllai i tij.

65. Qeveria parashtroi se pretendimet e kërkuesit nuk ishin të provuara, duke qenë se nuk kishte paraqitur ndonjë provë.

66. Gjykata përsërit se është konstatuar se autoritetet nuk kanë realizuar një hetim efikas, në kundërshtim me detyrimin procedural, sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës. Në lidhje me



konstatimin e shkeljeve dhe vlerësimin mbi baza të drejta, gjykata i keq kërkuesit 12 000 euro për dëmin jomonetar.

B. Kostot dhe shpenzimet

67. Kërkuesi, gjithashtu, pretendonte 10 000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra në gjykatat vendëse dhe për ato të përdorura përpara gjykatës. Kjo përfshinte një shumë për përfaqësimin e tij ligjor përpara Gjykatës Kushtetuese dhe përpara gjykatës me gjashtë përfaqësues ligjorë. Ai dorëzoi një faturë të përgjithshme dhe kontrata shërbimesh për përfaqësuesit ligjorë.

68. Qeveria parashtroi se këto pretendime ishin të tepruara dhe të pabazuara në fakte.

69. Gjykata konstaton se kërkuesi duhet të ketë pasur disa kosto dhe shpenzime gjatë procedimeve. Në këtë mënyrë, në çështjen në fjalë, duke pasur në konsideratë informacionin në dispozicion, gjykata e gjykon të arsyeshme t'i japë kërkuesit shumën prej 1450 eurosh për procedimet përpara gjykatës.

C. Interes i vonuar

70. Gjykata gjykon të përshtatshme se norma e interesit të vonuar duhet të mbështetet në normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane, shumë së cilës i shtohen tre pikë përqindjeje.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË ANONIME:

1. Vendos të bashkojë kundërshtimin paraprak në lidhje për mosshfrytëzim të mjeteve të brendshme, sipas cilësive dhe e pushon atë;

2. E deklaron kërkesën të pranueshme;

3. Vendos se është shkelur neni 2 i Konventës, në pjesën procedurale;

4. Vendos se nuk është shkelur neni 3 i Konventës, në pjesën thelbësore;

5. Vendos se është shkelur neni 3 i Konventës në pjesën procedurale;

6. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse është shkelur neni 13 i Konventës;

7. Vendos:

a) se shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve nga data në të cilin vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme:

i. 12 000 euro (dymbëdhjetë mijë euro) plus çdo taksë e cila mund të tarifohet, për dëmin jomonetar, shumë e cila duhet të konvertohet në monedhën e shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

ii. 1 450 euro (një mijë e katërqind e pesëdhjetë euro), plus çdo taksë, e cila mund të jetë e tarifueshme për kërkuesin, për kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i tre muajve të përmendur më sipër, deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm për shumat më sipër, në një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane, gjatë periudhës së vonesës, plus tre pikë përqindjeje.

8. Pushon pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesit për kompensim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim në datën 11 qershor 2019, sipas rregullave 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së gjykatës.

Stanley Naismith

Sekretar

Robert Spano

Kyetar

VENDIM

Nr. 146, datë 4.10.2019

MBI KËRKESËN E OSHEE SHA PËR SHTYRJEN E PERIUdhës TRANZITORE TË VENDOSUR ME PIKËN 2, TË VENDIMIT NR. 46, DATË 19.3.2019, TË BORDIT TË ERE-s, DERI NË FUND TË VITIT 2019

Në mbështetje të nenit 10, pika 2, të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 180 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 16 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.9.2019, mbasi shqyrtoi kërkesën e OSHEE sh.a., si dhe relacionin me nr. 92/3 prot., datë 27.9.2019, të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore, për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a., për zgjatjen e periudhës tranzitore të vendosur në pikën 2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 46, datë 19.3.2019, deri në fund të vitit 2019,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 19428 prot., datë 20.9.2019, i është drejtuar ERE-s me një kërkesë për zgjatjen e periudhës tranzitore të



vendosur në pikën 2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 46, datë 19.3.2019, deri në fund të vitit 2019.

- Me vendimin nr. 46, datë 19.3.2019, mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a., për shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar, nga ana e OSHEE sh.a. dhe çështje të tjera të rregullimit, bordi i ERE-s vendosi:

1. *Pezullimin e zbatimit të nenit 20, germa “a” të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, për sigurimin e energjisë elektrike nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a.*

2. *Vendosjen e një periudhe tranzitore prej 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, gjatë së cilës afati i kryerjes së pagesave nga shoqëria OSHEE sh.a. për tregtarët fitues të ankandevave të shitblerjes së energjisë elektrike, me qëllim sigurimin e energjisë elektrike për përmbushjen e nevojave të klientëve fundorë, mund të jetë jo më vonë se 180 ditë nga dita e livrimit të energjisë elektrike.*

3. *Pagesa që OSHEE sh.a. do të kryejë ndaj çdo tregtari me të cilin ka siguruar blerjen e energjisë të jetë proporcionale, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit për secilin tregtar, por jo më vonë se 180 ditë nga dita e livrimit të energjisë.*

4. *OSHEE sh.a. të informojë çdo fundmuaji në ERE, në lidhje me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi.*

5. *OSHEE sh.a. të rishikojë programin e zhvillimit ekonomik në funksion të ndryshimeve të këtyre efekteve financiare të parashtruara në shkresën e shoqërisë nr. 5477/1 prot., datë 08.3.2019.*

6. *OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të cilët kanë dakordësuar dhe kanë kryer shitblerjen e energjisë elektrike nën termat e ftesës së shpallur të OSHEE sh.a., që nga data 1 janar deri në hyrjen në fuqi të vendimit të ERE-s nr. 97, datë 21.6.2019, të respektojnë reciprokisht termat e ftesës së shpallur të OSHEE sh.a. dhe të ofertave të pranuar të tregtarëve të energjisë elektrike.*

OSHEE sh.a., kërkesën e saj, sa më sipër, e mbështet dhe e argumenton si në vijim:

- Si rezultat i rritjes së kostove të blerjes së energjisë elektrike, të cilat sipas vetë informacionit të përcjellë nga OSHEE sh.a., me shkresën nr. 19428 prot., datë 20.9.2019, për periudhën janar–korrik 2019, ishin 8.4 miliardë l ekë më të larta se ato të së njëjtës periudhë të vitit të kaluar dhe 9 miliardë lekë më të larta se ato të planifikuara.

Rezultati financiar i 7-mujorit të parë të vitit 2019 ishte negativ, për 3.9 miliardë lekësh, me gjithë uljen e ndjeshme të shpenzimeve, në krahasim me ato të planifikuara dhe rritjen e të ardhurave prej 6%.

- Kostoja e lartë e blerjes së energjisë elektrike, krijoi vështirësi të madhe likuiditeti për OSHEE sh.a., gjatë periudhës 7-mujore, të cilat megjithëse “u zbutën” nga lidhja e kontratave me afat pagese 180-ditore, nuk e kanë shmangur riskun e lartë të likuiditetit me të cilin OSHEE sh.a. po përballet.

- OSHEE sh.a. ka paguar deri në fillim të muajit shtator 2019, gjithë detyrimet për blerjen e energjisë nga tregu i lirë deri në muajin shkurt 2019 dhe, pjesërisht, ato të muajit mars 2019 ose rreth 49% të detyrimit prej rreth 19 milionë eurosh kosto energjie blerë në treg të lirë, gjatë muajit mars 2019.

- Parashikimet hidrologjike akoma nuk sigurojnë ndryshime thelbësore në situatën hidrike dhe prodhimi i KESH sh.a. pritet të jetë konsiderueshëm nën mesataren historike të planifikuar në buxhetin e vitit 2019, me vetëm 2.7 twh energji e parashikuar të prodhohet.

- Megjithëse OSHEE sh.a. ka ndryshuar afatet e pagesave për blerjen e energjisë elektrike në 180 ditë, si pasojë e rritjes së çmimit të blerjes së energjisë elektrike që parashikohet deri në fund të muajit mars 2020, OSHEE sh.a. do të ketë të pamundur të shlyejë të gjitha detyrimet e lindura për një shumë prej rreth 1.4 miliardë lekësh.

- Shtyrja e afateve të pagesës së detyrimeve, për blerjen e energjisë elektrike, është në vetvete një nga masat e marra për të zbutur efektet e humbjeve financiare, për shkak të rritjes së kostos së blerjes së energjisë elektrike në kushtet e uljes së prodhimit të KESH sh.a. Duke qenë se shkak i rritjes së kostove dhe i humbjeve financiare është natyror (varësi nga moti i thatë), OSHEE sh.a. nuk mund të marrë asnjë masë paraprake në kushtet e akteve ligjore dhe metodologjive ekzistuese të llogaritjes së çmimeve dhe tarifave në fuqi. Asnjë fond rezervë nuk është parashikuar për këto raste, në përlllogaritjen e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për konsumatorët tarifarë.

ERE vlerëson si më poshtë vijon:

- Stabiliteti financiar i shoqërisë OSHEE sh.a. konsiderohet i një rëndësie të veçantë për sa i përket interesit publik që ka mbarëvajtja e kësaj shoqërie, si i ngarkuari me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit, mbështetur në VKM-në nr.



244/2016, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar.

- Situata financiare dhe hidrologjike, në muajt në vijim, nuk garanton një parashikim optimist të situatës së furnizimit me energji elektrike nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës zotërohen plotësisht apo pjesërisht nga shteti, në zbatim të detyrimeve të kësaj të fundit për të siguruar pjesën më të madhe të nevojës për furnizim me energji elektrike, me sasi e çmime të rregulluara nga kontrata e miratuar mes palëve.

- Sasia vjetore prej 3950 gw, e parashikuar nga kontrata e nënshkruar mes palëve KESH dhe FSHU, për vitin 2019, si detyrim i KESH sh.a. për të garantuar furnizimin me energji elektrike të OSHEE sh.a., në cilësinë e furnizuesit të shërbimit universal, nuk garanton vijueshmërinë në sasi e në cilësi të nevojës së furnizimit të klientëve fundorë.

- Kostoja e lartë e blerjes së energjisë elektrike nga tregu i parregulluar, si pasojë e çmimit të tregut, krijon vështirësi të madhe likuiditeti për OSHEE sh.a.

- Në kushtet e motit të lagësht, OSHEE sh.a., për shkak të detyrimit me të cilin e ngarkon VKM-ja nr. 244/2016, rrit sasinë e blerjes së të gjithë sasisë së energjisë së prodhuar nga HEC-et, të cilat kanë një çmim prej 8.5 lekë/kwh, ndjeshëm më të lartë se ai me të cilin siguron energjinë nga KESH sh.a., me 1.5 lekë/kwh.

- Vlerësohet si i mundshëm, dëmi që mund t'i shkaktohet shoqërisë në kushtet e pamundësisë paguese.

- Merret në konsideratë parashikimi i nenit 180 të Kodit të Procedurave Administrative, që sanksionon, se: “Ekzekutimi i detyrueshëm pezullohet kryesisht ose me kërkesë të subjektit të ekzekutimit, në rastet kur: a) vërtetohet se ekziston rreziku i shkakut të një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për subjektin e ekzekutimit dhe pezullimi në këtë rast nuk e cenon interesin publik.”. Në këtë rast, për shkak të rëndësisë së madhe të operatorit të shpërndarjes si i ngarkuari me detyrimin e shërbimit universal të klientëve fundorë dhe stabilitetit të tij financiar, pezullimi garanton një performancë më të mirë dhe, për

rrjedhojë, garanton edhe qëndrueshmërinë e shërbimit për klientët fundorë.

- ERE mori parasysh qëndrimin dhe argumentet e palëve të interesit, të përfaqësuar nga OSHEE sh.a. dhe përfaqësuesi i shoqërisë Gen-I Tirana sh.p.k., në lidhje me këtë kërkesë.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE nr. 46, datë 19.03.2019 “Mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a., për shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar, nga ana e OSHEE sh.a. dhe çështje të tjera të rregullimit, deri në 31.12.2019

2. Vijimin e pezullimit të zbatimit të nenit 20, germa “a” të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen, dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, për shoqërinë OSHEE sh.a., sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Pagesa që OSHEE sh.a. do të kryejë ndaj çdo tregtari me të cilin ka siguruar blerjen e energjisë, të jetë proporcionale, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit për secilin tregtar, por jo më vonë se 180 ditë nga dita e livrimit të energjisë.

4. OSHEE sh.a. të marrë masa dhe të informojë periodikisht në ERE, në lidhje me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë aplikuesin dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 147, datë 4.10.2019****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “FURNIZUESI I
SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU)” SHA,
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “d”, të nenit 5, pika 1, germa “d”, të nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe të nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e datës 4.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 92/2 prot., datë 30.9.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 519 prot., datë 27.8.2019, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike;

- në zbatim të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe të urdhrit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157 prot., datë 12.2.2018 të shoqërisë OSHEE sh.a., në cilësinë e aksionarit themelues, në datën 28.3.2018 është themeluar shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.), për kryerjen e aktivitetit të furnizimit;

- ERE, me vendimin nr. 215, datë 11.10.2018, transferoi licencën e furnizimit të energjisë elektrike me nr. 251, me seri P14FPP, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri në datën 27.10.2019, dhe të detyrimit

të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, të shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.);

- pas konstatimit se ky aplikim është kryer nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a. dhe jo nga shoqëria e krijuar për ushtrimin e aktivitetit të furnizimit “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.), ERE, me shkresën nr. 519/1 prot., datë 12.9.2019, iu drejtua shoqërisë OSHEE sh.a. dhe për dijeni shoqërisë FSHU sh.a., duke i bërë me dije se aplikimi për rinovimin e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike nr. 251, seria P14FPP, duhet të kryhet nga shoqëria FSHU sh.a.;

- në përgjigje të sa më sipër, shoqëria FSHU sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 519/2, datë 17.9.2019, ka përcjellë aplikimin për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë FSHU sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “e” dhe “f”, pika 4.7.1, gjerat “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë, me:

- “dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, neni 9, pika 2, germa “c” (Vërtetimi i regjistrimit nga QKB-ja), pavarësisht se nga ekstrakti i QKB-së rezulton se shoqëria FSHU sh.a. është regjistruar në QKB, në datën 30.3.2018, me NUIS L81530016L, ajo nuk ka përcjellë në ERE dokumentin “Certifikatë e regjistrimit”; do të njoftohet aplikuesi, që në bazë të nenit 10, pika 9



dhe të nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ta paraqesë në ERE, brenda afateve;

- vërtetimet nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë, të lëshuara për shoqërinë FSHU sh.a., do të kërkohej që të depozitohen në ERE, në zbatim të nenit 8, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të lëshuara jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.), në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 148, datë 4.10.2019

MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË OST SHA, PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË “RREGULLAT E PËRKOHSHME TË MEKANIZMIT BALANCUES”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 193, DATË 24.11.2017

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 98 dhe të nenit 100, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15 dhe të nenit 26 të “Rregullores për organizimin,

funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 4.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 92/6, datë 30.10.2019, të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., për miratimin e disa shtesave në “Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 26/1, datë 14.1.2019, ka kërkuar rishikimin e “Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, duke propozuar:

Në nenin 12, pika 2, pas germës “c” të shtohet germa “d”, me këtë përmbajtje:

Të dispeçuar për të reduktuar prodhimin e energjisë elektrike ose për të rritur konsumin si shërbim balancimi do të paguajë me çmimin e llogaritur si HUPX DAM, çmim të një ore specifike të shumëzuar me një faktor prej 0.5 për çdo mwh të disbalancës.

Në nenin 12, pika 3, pas germës “c” të shtohet germa “d”, me këtë përmbajtje:

Të dispeçuar për të rritur prodhimin e energjisë elektrike ose të reduktojë konsumin si shërbim balancimi do të paguhet me çmimin e llogaritur si HUPX DAM, çmim të një ore specifike të shumëzuar me një faktor prej 0.5 për çdo MWH të disbalancës.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 19, datë 18.2.2019, filloi procedurat për miratimin e disa shtesave në “Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje dhe në zbatim të nenit 26, pikat 3 dhe 5 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin të bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, ERE, me shkresën 32/6 prot., datë 18.2.2019, publikoi në medien e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure, nga ku rezultoi se nuk u paraqit asnjë opinion ose sugjerim nga palët e interesit, në lidhje me këto shtesa.

- ERE, në zbatim të nenit 15, pika 3 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, me shkresën nr. 177 prot., datë 21.2.2019, përcolli për marrje mendimi në lidhje me vendimin e bordit nr. 19, datë 18.2.2019, pranë palëve të interesit, Ministrisë së



Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë OSHEE sh.a. Në përfundim të afatit 15-ditor, vetëm shoqëria KESH sh.a. ka shprehur mosdakordësinë e saj në lidhje me këto shtesa, për aq kohë sa mungojnë analizat e shkaqeve që motivojnë kërkesën për ndryshim.

- Po ashtu, me shkresën nr. 178 prot., datë 21.2.2019, ERE i kërkoj OST sh.a. kryerjen e simulimeve dhe argumentimet përkatëse që vlerësojnë sjelljen me propozimet e reja, si dhe konsultimet e propozimeve me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, si bashkëpërpilues të këtyre rregullave, sipas parashikimeve, gjithashtu, të pikës 2 të vendimit të mësipërm.

- Nga ana e saj shoqëria OST sh.a., nëpërmjet shkresë me nr. 26/4 prot., datë 28.3.2019, protokolluar në ERE me nr. 178/1 prot., datë 29.3.2019, informon se ka përcjellë pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për mendim, shtesat e propozuara së bashku me simulimet përkatëse.

- ERE, me shkresën nr. 178/2 prot., datë 5.4.2019, ka kërkuar prej shoqërisë OST sh.a., të përcjellë pa vonesë pranë ERE-s dhe palëve të interesit, simulimet, sikurse kërkohet në pikën 2 të vendimit të bordit nr. 9, datë 18.2.2019.

- Në përgjigje të shkresës sipërcituar, OST sh.a., nëpërmjet të sajës nr. 26/6 prot., datë 16.4.2019, protokolluar në ERE me nr. 178/3, datë 17.4.2019, ka bërë me dije ERE-n dhe KESH sh.a., në lidhje me simulimet e kryera, të cilat faktojnë se ndryshimet e kërkuara prej saj janë të argumentuara.

- Më tej, në përgjigje të shkresës së përcjellë nga ana e OST sh.a., me shkresën nr. 178/4 prot., datë 8.5.2019, kemi kërkuar prej shoqërisë OST sh.a., që të depozitojë pranë ERE-s simulimet me të dhëna të detajuara faktike të përlllogaritjes së disbalancave, për periudhat përkatëse në të cilat pretendohet se mekanizmi balancues në fuqi, nuk ka adresuar në mënyrë konkrete kostot dhe të dhënat me ndryshimet e koeficienteve, siç propozohet nga OST sh.a., pasi simulimet e paraqitura rezultojnë të përgjithshme dhe nuk evidentonin saktë problematikën e pretenduar në kërkesën e OST sh.a.

- OST sh.a., me shkresën nr. 26/9 prot., datë 17.5.2019, protokolluar në ERE me nr. 178/5, datë 20.5.2019, ka përcjellë përlllogaritjen e disbalancave

vetëm për muajin shkurt 2019, e cila nuk rezulton të jetë e detajuar dhe e argumentuar sa duhet, si dhe kopje të korrespondencës së dërguar për konsultim te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

- Gjithashtu, me shkresën nr. 26/10 prot., datë 21.5.2019, protokolluar në ERE me nr. 178/6, datë 23.5.2019, shoqëria i është drejtuar ERE-s dhe KESH sh.a., për të sqaruar se, duke qenë në cilësinë e operatorit të sistemit, është përgjegjëse për të ndërmarrë masat e nevojshme për të balancuar sistemin fizikisht dhe të administrojë procesin e llogarive financiare, por në asnjë rast OST sh.a., nuk synon një rezultat financiar në favor të portofolit të vet, pasi ky portofol duhet të jetë neutral, por aplikimi i koeficientëve aktualë ka krijuar humbje në portofolin e llogarive të disbalancave. Nisur nga ky fakt theksojnë, se kostot financiare nuk janë derivat të mënyrës se si menaxhohet sistemi i transmetimit, por janë derivat të balancimit në kohë reale të sistemit të transmetimit dhe se është detyrim i saj balancimi kundrejt sistemeve fqinje. Po ashtu, OST sh.a. nuk synon ndarjen e kostove të balancimit me ofruesin e shërbimit të balancimit dhe se mekanizmi balancues në fuqi synon të penalizojë nëpërmjet disbalancave të gjithë pjesëmarrësit që operojnë në treg, për disbalancat që këta të fundit krijojnë.

- ERE, nëpërmjet shkresës me nr. 178/7 prot., datë 3.7.2019, duke pasur parasysh rëndësinë që kanë këto rregulla i ka kërkuar OST sh.a., qëndrimin përfundimtar të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për shtesat e propozuara në “Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues”, me qëllim mostejkalimin e afateve të përcaktuara në ligj për t’i dhënë fund praktikës së nisur nëpërmjet vendimit të bordit të datës 18.2.2019.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria OST sh.a., me shkresën me nr. 4477/2 prot., datë 25.7.2019, protokolluar në ERE me nr. 178/9, datë 29.7.2019, ka bërë me dije, se është akoma duke bërë simulime në lidhje me impaktin që do të japin ndryshimet e kërkuara në “Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues” dhe, aktualisht, po analizon dhe po monitoron sjelljet e pjesëmarrësve të tregut konform mekanizmit balancues në fuqi, si dhe kërkon të vazhdojë vlerësimin dhe për një periudhë tjetër njëmuajore, periudhë e cila ka përfunduar në datën 29.8.2019.



- ERE, me vendimin e bordit nr. 118, datë 22.7.2019, ka filluar, gjithashtu, procedurën për miratimin e “Rregullave përfundimtare të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”. Me miratimin dhe me hyrjen në fuqi të këtyre rregullave do të shfuqizohen të gjitha aktet e tjera me të cilat, aktualisht, rregullohet mekanizmi balancues i tregut të energjisë elektrike, përfshirë dhe rregullat tranzitore.

- Në përfundim të afateve, si dhe pas korrespondencave të shumta mes ERE-s dhe OST sh.a, si dhe për gjithë sa sipërcituar, konstatojmë që:

- Nuk ka një qëndrim të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me shtesat dhe ndryshimet e propozuara nga ana e OST sh.a. në “Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues”, siç kërkohet në pikën 2, të vendimit nr. 19, datë. 18.2.2019, të bordit të ERE-s.

- Duke qenë vetë OST sh.a., e cila me konsulencën përkatëse të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ka propozuar këto rregulla për balancimin e sistemit të energjisë elektrike, pjesë përbërëse të të cilave ishin dhe koeficientët përkatës, gjatë procesit të përpilimit dhe të miratimit, nuk ka pasur pretendime nga asnjë nga palët lidhur me to, përfshirë këtu OST sh.a.

- Rregullat ekzistuese përfshirë dhe koeficientët e vendosur kanë pasur si qëllim neutralitetin financiar të OST sh.a. dhe, si të tilla, nuk mund të krijojnë kosto financiare për operatorin e sistemit.

- OST sh.a., deri më sot, nuk argumentoi dhe as dokumentoi me kalkulime, se në ç’mase zbatimi i koeficientëve që përcaktohen aktualisht në mekanizmin e përkohshëm të balancimit, jep efekte negative për shoqërinë dhe as se ndryshimet e propozuara do të shmangin në të ardhmen këto efekte të prezumuara.

- Për më tepër që, vetë OST shprehet në shkresën e datës 25.7.2019, se, citojmë: “është akoma duke bërë simulime në lidhje me impaktin që do të japin ndryshimet e kërkuara në “Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues” dhe, aktualisht, po analizon dhe po monitoron sjelljet e pjesëmarrësve të tregut”, si rrjedhojë përcjellja e propozimit për ndryshimin e rregullave ka qenë pa bërë simulimet e duhura.

- Duke qenë se ka kaluar një kohë relativisht e gjatë që nga adresimi i kërkesës për shqyrtimin e propozimeve, nëpërmjet vendimarrjes së ERE-s

për fillimin e procedurës së shqyrtimit të këtyre propozimeve dhe me gjithë kërkesën e vetë OST sh.a., për një periudhë njëmuajore dhe kjo periudhë u tejkalua nga këta të fundit.

- Duke qenë se pas marrjes së propozimit të OST sh.a. për miratimin e rregullave të mekanizmit të balancimit të tregut të energjisë elektrike, bordi i ERE-s ka filluar tashmë procedurën për shqyrtimin dhe për miratimin e këtij akti rregullator definitiv i cili mund dhe duhet të adresojë çdo problematikë të konstatuar pas hyrjes në fuqi të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të modelit shqiptar të tregut të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Refuzimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për miratimin e disa shtesave në “Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë OST sh.a. dhe palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 933(3797), datë 18.7.2019, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Emorela Sokol Dema, e lindur në datën 13.6.1996, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë ligjore të kërkuases Rezarta Dema.

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 926 (3771), datë 17.7.2019, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Mariglen Trajani, i lindur në datën 6.6.1991, Tiranë dhe zëvendësimin e kujdestarisë ligjore nga “Motrat Nënë Tereza, Misionaret e Bamirësisë”, me seli në Shkodër dhe vendosjen e tij nën kujdestari të palës tjetër kërkuese, person juridik kishtar, “Shtëpia Rregulltare e Bashkësisë Misionarët e Dashurisë Kontemplative”, me seli në Njësinë Administrative Bushat, Bashkia Vau i Dejës.

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2018-3728) 1017, datë 1.7.2019, vendosi deklarimin e vdekjes së shtetasës Rabije Sali Azizi, e datëlindjes 10.7.1925, në datën 6.9.1998, në Dovolën, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër.

KËRKESË

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, përfaqësuar nga prokurori Alfred Sali, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Adriano (Fatosh) Jaho (Jahaj), i datëlindjes 30.3.1965, lindur dhe banues në Vlorë.

KËRKUES**Prokuror Alfred Sali**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 308 lekë